

الله  
رسول  
محمد

# **ATA TË CILËT I SHFRYTËZOJNË TË GJITHA KËNAQËESITË E TYRE NË KËTË JETË**

E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe i përjetuat ato, e sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhërat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënçmues.

(Surja Al Ahkaf-ajeti 20)

**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**

**B**ota është e mbushur me bekime të panumërta, por shumë njerëz as që janë në dijeni të tyre. Të varrosur në dhimbjet dhe ankthet e tyre, ata nuk mund të shohin bukuritë për rreth tyre ose të marrin kënaqësi nga gjërat që ata përjetojnë. Në qoftë se ju i pyesni, ata do të thonë se jeta është një luftë e vështirë, një pjerrësi e madhe, ata janë të mërzhitur dhe rraskapitur me jetën. Ata vazhdimisht ankohen se nuk gjejnë ndonjë kënaqësi në të, se ata duan të vdesin në mënyrë që të shpëtojnë. Disa madje shkojnë aq larg sa kryejnë vetëvrasje.

Por jeta nuk duhet të jetë në këtë mënyrë. Sigurisht, jeta është krijuar me sprovë, me të meta dhe kufizime. Por mënyra për t'i përballur këto nuk është që të luftojnë me jetën, përkundrazi, zgjidhja qëndron në të besuarit në Allahun.

Ky libër përpiqet të tregojë mundimin, humbjen, dhe ankthin që rrjedhin nga të jetuarit larg nga feja, njerëzit tregojnë gjendjen në të cilat ata kanë rënë, duke i informuar ata se si të mbajnë bekimet e të mirat e tyre në këtë botë, dhe për të shpëtuar veten nga dhembjet e që ata do të vuajnë në botën tjetër. Përveç kësaj, ne do të donim që të gjithë njerëzit të kuptojnë se kjo jetë është e mbushur me mira dhe gjëra të tjera të këndshme që njerëzit mund të gëzojnë, me kusht që ata të besojnë në Allahun. Dhe së fundi, ky libër fton të gjithë që të ndjekin rrugën e Tij, të jetojnë sipas Kur'anit, dhe të jetojnë një jetë me besim.

## RRETH AUTORIT



Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الله  
رسول  
محمد



# Ata të cilët i shfrytëzojnë të gjitha kënaqësitë e tyre në këtë jetë

*Ë në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dnyjës dhe i përgjetuat ato, e sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhërat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënqumës.*

*(Surja Al Ahkaf-ajeti 20)*

**HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)**



## Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi.



Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

# Për lexuesin

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfitur nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.



# PËRMBAJTJA

Parathënie .....	8
Ata të cilët shijojnë të gjitha kënaqësitë e tyre në këtë jetë .....	11
Besimi është mënyra e vetme për t'i shijuar begatitë .....	18
Kënaqësitë e kësaj bote të humbura nga pabesimtarët.....	21
Është e mundshme t'i kthejmë këto kënaqësi të humbura .....	91
Vdekja: Momenti kur mbarojnë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote .....	96
Begatitë e humbura në botën e ardhshme .....	100
Përfundim .....	107
Mashtrimi i evolucionit .....	110

## Parathënie

**B**ota është e mbushur me begati të panumërta, por shumë njerëz bile as që janë në dijeni për to. Të thelluar në dhimbjet dhe ankthet e tyre ata nuk mund t'a shohin bukurinë përreth tyre ose t'i pëlqejnë gjërat që i përjetojnë. Sikur t'i pyesje, ata do të thonin se jeta është një betejë e vështirë në një shpat (breg) të rrëpirët, për çka edhe janë të mërzitur dhe të lodhur nga ajo (jeta). Ata vazhdimisht ankohen se nuk gjejnë më kënaqësi dhe se dëshirojnë të vdesin për të ikur nga ajo. Disa prej tyre e teprojnë aq shumë sa që tentojnë të bëjnë vetëvrasje. Por, jeta nuk duhet të jetë kështu. Natyrisht, ka qenë e krijuar se bashku me shumë papërsosmëri dhe kufizime. Por mënyra për t'i përballuar ato nuk është beteja me jetën, zgjedhja më tepër qëndron në besimin në Allah-un, kështu:

**Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. ( Surja An Nahl: 97)**

Bota, së bashku me papërsosmëritë e saj, është e mbushur me begati të panumërta. Dhe për ata që botën e shohin me sy të besimit, begatitë e saj shpirtërore dhe materiale janë të vazhdueshme (pa fund). Si rezultat, ata nxjerrin një kënaqësi të thellë, duke qenë në gjendje të shohin mirësitë dhe bukurinë në cdo vend dhe në çdo situatë.

Shumë njerëz të cilët jetojnë pavarësisht nga Allahu, kurrë as që kanë dëgjuar për këto kënaqësi, pasi që shpirti i tyre i rebeluar ka bërë që ata qysh moti të harxhojnë çfarëdo të mire që mund të gjejnë në begatitë e tyre. Në mungesë të besimit ata shpenzojnë atë që mbetet nga jetërat e tyre si,, shpirtëra të humbur.” Jëterat e tyre dominohen nga lodhja, mërzia, zbrazësia (boshllëku) dhe dëshira e paplotësuar. Koha kalon, por edhe në çoftë se ata do t’ mund t’ i shihnin gjërat e mira të panumërta rreth tyre, nuk do të ishin në gjendje të arrinin ndonjë kënaqësi të vërtetë në to. Për më tepër, ankthet (shqetësimet) që ata përjetojnë nuk janë të kufizuara në jetën e tyre në këtë botë. Allahu thot se ata që prishin kot qejfet e kësaj bote do t’u hjeket e drejta (privohen) në të përjetësisht në jetën e përtejme (botën tjetër).

**E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): Ju i shfryëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe i përjetuat ato, e sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhërat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënçmues. (Surja Al Ahkaf-ajeti 20)**

Por askush nuk kishte dashur të jetë në një gjendje të tillë ose të marrë një shpërblim të tillë në cilëndo botë. Përkundrazi, gjithkush do të donte t’i përjetonte kënaqësitë më të mira prej

mundësive që Allahu iu dhuron në të dy botërat. Dhe, nëse Allahu don, këto dëshira mund të arrihen goxha lehtë. Ky libër përpiket tju tregoj privimin ( heqjen e ndonjë të mire ), humbjën, dhe shqetësimin ( ankthin) që vjen nga të jetuarit larg fesë, tju tregoj njerëzve gjendjën në të cilën kanë rënë ata, t'i informoj si t'i mbajnë kënaqësitë në këtë botë dhe të ruhen nga brejtja e ndërgjegjës për të cilën do të vuajnë në jetën e përtejme.

Veç kësaj ne kishim pasur dëshirë t'u përkujtojmë njerëzve se kjo jetë është përplot me begati dhe gjëra tjera të mira që njerëzit mund t'i shijojnë, me kusht që ata të besojnë në Allahun. Përfundimisht, ky libër fton çdokend të ndjek Rrugën e Tij. T'i nënshtrohet Kur'anit dhe të jeton jetën në besim.

## **Ata të cilët shijojnë të gjitha kënaqësitë e tyre në këtë jetë**

**N**jë shiqim i shpejtë në histori tregon se shumë njerëz kanë një gjë të përbashkët: qoftë të rinj apo të moshuar, të pasur apo të varfër, ankesa për jetën e tyre është pjesë e rëndësishme e stilit të tyre të jetës. Gjithcka që ndodh i jep atyre një mundësi për të shprehur pakënaqësinë e tyre. Edhe në qoftë se diçka duket se ka njëqind aspekte të mira dhe të këndshme, në vend se të jenë të kënaqur, ata vërejnë disa papërsosmëri dhe bëhen nervoz. Kjo mënyrë e të menduarit është bërë aq e rrënjosur sa që ata reagojnë në mënyrë të njejtë për gjërat të cilat as nuk i kanë parë e as nuk i kanë përjetuar, sepse ata mendojnë për vështirësitë e mundshme dhe kështu e bëjnë vehtën jo të lumtur. Si rezultat, ata lodhen mjaftë shumë për arsye që ata nuk mund t'i kuptojnë dhe ndjejnë se kur nuk do të jenë mjaftë të kënaqur për dicka. Pa dyshim ju njihni njerëz që ankohen: “Nuk e di çka nuk është në rregull me mua” “jam aq i mërzhitur” “jam ngopur me këtë jetë”, ose “nuk jam në qejf me bë diçka”. Nëse keni provuar t'i ndihmoni në lodhjet e rrënjosura

të kësaj bote dhe pakënaqësinë, sipas gjitha gjasave kishit me dështu.

Edhe ne qoftë se kishit për t'i quar në vendin më të bukur të botës t'i shpalosni begatitë më të mrekullueshme para tyre, dhe t'ju mundësonit çdo luks që zemrat e tyre do të dëshironin ju nuk do të mund t'i bënit ata t'i shijojnë këto gjëra ose të bëni që këto begati të kenë ndikim të përhershëm në shpirtërat e tyre. Me fjalë të tjera, ju kurrë nuk do të mund t'i bënit ata vërtetë të lumtur.

Sidoqoftë, cdo vend, nga qiejt e lartë e deri tek detet e thella, është i mbushur me mrekulli të panumërta: qenie të gjalla të bukura (P.sh. zogj, lepuj, ketra, luana, zebra, pantera, tigra, maca, qenë dhe peshqi) mijëra lloje frutash (psh: dredhëza, portokaj, bostana, kumbulla dhe pjeshka), bimë që ngazëlleshin shpirtin (trëndafila, orkide, margaritë, manushaqe, zymbyl, dhe karanfila) dhe shumë gjëra të tjera të bukura që e kënaqin shpirtin njerëzor. Një pamje e bukur, një fytyrë e këndshme njeriu, ose një ushqim i mirë i japin një kënaqësi të madhe shpirtit të njeriut : në Kur'an Allahu numëron për ne shumë gjëra të bukura që Ai na ka ofruar ne në këtë jetë, dhe na sjell ndër mend se këto begati janë aq të shumta në numër dhe të larmishme për ne bile edhe vetëm për t'i numëruar.

**32. All-llahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën, dhe lëshoi prej së larti ujë (shi), e me të nxjerr fruta si ushqim për ju, dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhërin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë. Për ju nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën. Dhe Ai ju dha gjithatë që e kërkuat (që kërkoji nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të**

**mirat (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë për përbuzës. (Surja Ibrahim 32-34).**

**18. Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato. Me siguri All-llahu shumë fal dhe shumë mëshiron. (Surja Nahl 18)**

Vetëm njëra prej këtyre begative i jep kënaqësi shpirtit njerëzor. Prandaj, është shumë e çuditshme nëse dikush që jeton midis këtyre gjërave të bukura të mos i vërej ose të mos jetë i kënaqur me to. Kjo është një humbje e madhe. Me sa duket, njerëzit e tillë i kanë shijuar dhe harxhuar të gjitha kënaqësitë e kësaj bote dhe tash ato u duken të mërzitshme. Është një kundërshtim i madh se ata që japin arsytetime të dobëta për t'iu shmangur fesë dëshirojnë t'a shohin këtë botë si një vend ku mund të qeshin dhe të kënaqen. Qëllimi i tyre më i madh është të shijojnë sa më shumë kënaqësi që mundën. Ky ligj universal ka mbetë i pandryshuar gjatë epokave. Disa prej atyre që nuk e kuptojnë kuptimin e vërtetë të jetës kanë zhvilluar filozofi të bazuara në kënaqësitë e kësaj bote dhe i kanë lavdëruar ata që përpiqen të “bëjnë sa më shumë për një ditë”.

Horaci (65-8 Para Krishtit) poet lirik i njohur romak, ka thënë: **carpe diem** (zëre ditën), mbizotëruese qysh nga shekull i shtatëmbëdhjetë, përmbledh një filozofi të jetës të bazuar vetëm në jetën e kësaj bote. Me pak fjalë, don të thotë, se një person nuk duhet të mendoj për nesër, por të jetoj për momentin, dhe të bëjë më së shumti prej secilës ditë, dhe se ata nuk duhet t'a kenë parasysh se vdekja mund të vjen në çdo moment ose të mendojnë se çka vjen pas kësaj. Në të njejtën mënyrë motoja e epokës së Rilindjes *memento mori* (kujtohu se do të vdisësh) ju sjell ndër

mend njerëzve se ata do të vdesin dhe se ata duhet të përqafojnë botën sa më shumë që mundën. Sipas kësaj ideje njerëzit nuk duhet të kenë frikë nga vdekja, më tepër, duke e ditur se ajo është afër, ata duhet të jetojnë si të dëshirojnë, të mos njohin kufij, dhe të ndjekin vetëm kënaqësinë e tyre.

Gjatë historisë, shoqëritë që kanë kërkuar një jetë të mirë dhe të lumtur jashtë shpalljeve të Allahut kanë zhvilluar shumë ide dhe filozofi të çuditshme. Një veti që të gjithë e kanë të përbashkët, sidoqoftë, është ideja se njerëzit duhet t'i kënaqin (shuajnë, paqësojnë) pasionet dhe dëshirat e tyre dhe t'i shfrytëzojnë plotësisht të gjitha begatitë që u dalin përpara, Allahu ju tërheq vërejtjen ambicjeve të këtyre njerëzve:

**29. Andaj ti largohu prej atij që ia ka kthyer shpinën Kur'anit dhe që nuk do tjetër pos jetës së kësaj bote! (Surja Nexhm 29)**

Në vend se t'i falemnderohen Atij për begatitë dhe mundësitë e panumërta që iu janë dhënë, ata jetojnë me një lakmi të pangopur.

**11. Ti, më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar. Dhe bëra këtë pasuri të madhe. E bëra edhe me djem që i ka me vete. Dhe Unë i lash në disponim të gjitha mundësitë. E ai lakmon që t'i shtoj edhe më tepër. (Mudethirr 11-15)**

Përse njerëzit e gjejnë vehtën të paplotësuar? Përse nuk mund t'a shijojnë këtë jetë, njerëzit tjerë, natyrën dhe sendet e gjalla? Qëllimi i tyre i vetëm është t'i shfrytëzojnë kënaqësitë e kësaj bote. Pse, atëherë, ata nuk janë në gjendje t'i shijojnë këto kënaqësi? Përse janë ata kaq të shqetësuar, të pikëlluar, të brengosur, dhe të lodhur pas kësaj bote?



Si kanë rënë ata në një situatë shpirtërore që i parandalon ata t'i vërejnë dhe shijojnë këto begati dhe bukuri?

Përse e kanë harxhuar ata tërë kënaqësinë e kësaj bote dhe nuk gjejnë lumturi në të? Për këto pyetje ka vetëm një përgjigje: Mohimi i Allahut nga ata, mosmirënjohja e tyre ndaj Tij dhe begatitë të Tij bëjnë zemrat e tyre të shqetësuara:

**Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamit. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngusht si tëngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. (An'am 125)**

Për shkak të mohimit të tyre Allahu dëshiron që ata të jetojnë në errësirë dhe pikëllim, edhe pse janë të rrethuar me gjëra të bukura.

**257. All-llahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë. E kujdestarë të atyre që nuk besuan janë djajtë që i nxjerrin ata prej drite e i hudhin në errësira. Ata janë banues të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. (Bekare 257)**

Pasi që Allahu e krijoi këtë botë si një vend testues, njerëzit që jepen pas zbukurimeve të kësaj bote bëjnë një gabim të madh. Në një hadith (thënie) të tij Profeti Muhamedi s.a.v.s thot:

*Bota është e kënaqshme, Allahu do tju bëjë trashëgimtar dhe do të shiqoj se si do të silleni atje. Pra, shmangiuni botës. (Sahih Muslimi dhe AL-Tirmidhi).*

Kur kuptojmë se të gjitha begatitë e kësaj bote janë një dhuratë nga Allahu dhe jemi falemnderues për to, e kënaqim Allahun. Si rezultat, ne gjithmonë jemi në dijëni se bukuria, begatitë, dhe gjërat e mira rreth nesh vijnë nga Ai.

Megjithatë, ata që e mohojnë Allahun nuk e shohin këtë të vërtetë. Në vend të kësaj, ata e ignorojnë Atë dhe I kënaqin (paqësojnë, zbusin) dëshirat dhe pasionet e tyre. Pasi ata të kënaqen më shumë e më shumë me këto begati, gjithashtu pakënaqësia e tyre rritet, sepse ato harxhohen nga dëshira e çmendur për të poseduar çdo gjë. Në vend që të jenë të kënaqur me çka kanë, ata janë jo të lumtur deri sa të marrin edhe më shumë. Dhe si rezultat, ata kurr nuk mund t'i çmojnë plotësisht begatitë e panumërta dhe potencialet e pakufishme që ata tashmë i posedojnë. Për shembull: ata mund të kenë një veturë të mirë por të bëhen të pakënaqur sapo të del një model i ri. Ata besojnë se shkuarja në pushime do t'i jap fund të gjitha vështirësive të tyre; sidoqoftë, pengesa më e vogël ju shkakton atyre mizori dhe shqetësim. Ata nuk provojnë t'i tejkalojnë vështirësitë e tyre me durim dhe nënshtrim ndaj fatit, por bëhen pesimist dhe kthejnë edhe më shumë shqetësim dhe dëshpërim. Edhe nëse janë kënaqur, kënaqësia e tyre është e përkohshme, shqetësimi tjetër zgjatë shumë më tepër. Natyrisht, ky vend testimi, është përplot me gjëra të bukura dhe gjithashtu me të meta, papërsosmëri, dhe mungesë të qëndrueshmërisë, dhe do të hasin në gjitha këto. Për shembull, njerëzit e pasur mund t'a humbin pasurinë e tyre gjatë një aksidenti apo katastrofe, njerëzit tërheqës mund t'i humbin dukjet e tyre, dhe njerëzit mençur mund t'i humbin aftësitë e tyre mendore. Veç kësaj, rinia dhe shëndeti i tyre, si dhe energjia dhe fuqia e tyre, do të dështojnë me kohën. Njerëzit të cilët nuk pasojnë parimet morale të Kur'anit gjithashtu brengosen për t'u takuar me njerëz të nivelit më të lartë shpirtëror dhe material. Fakti që disa njerëz janë më të pasur, më tërheqës, më të suksesshëm, më inteligjent, dhe kanë një rreth shoqëror më të

gjerë se sa ata, që zhytë (kredhë) ata në një depresion të thellë. Pra, kjo mënyrë kokëforte e të menduarit shpjegon se pse ata që mohojnë Allahun janë në kërkim të përjetshëm dhe nuk mund të kënaqen me ate çka kanë. Dëshirat e tyre ju vështërsojnë jetërat për çka edhe nuk mund t'a vlerësojnë ose të kënaqen me ate çka kanë. Duke besuar se të gjitha begatitë mbarojnë me vdekje, ata i hargjojnë dhe konsumojnë gjërat e tyre të mira një nga një. Bukuria, rinia, shëndeti dhe të gjitha janë kalimtare për ta, dhe dëshirat e forta ( egra) të egos së tyre i bëjnë ata jo të lumtur me atë çka kanë ( posedojnë). Dhe kështu ata jetojnë në mjerim në të dy botërat:

**E ata thonë: “Po qe se jeni të sigurt në ato çka flitni, kur do të realizohet ai premtimi (me dënim)?” Ti thuaj: “Tanimë u është ngjeshur juve një pjesë e atij premtimi për të cilin po ju ngutet juve!” (En Neml 71-72)**

Pjesë e këtij mjerimi është se njerëzit jetojnë në një lloj Ferri në këtë botë, edhe pse janë të rethuar me bukuri dhe shanse (mundësi). Shumë njerëz ekzistojnë në këtë gjendje shpirtërore, dhe kështu zbulojnë se niveli i tyre i shqetësimit, depresionit, stresit, dhe problemeve psikologjike vazhdojnë të rriten. Ata që ankohen vazhdimisht, duke thënë : “Nuk e di pse ndihem kaq i shqetësuar”, “jam aq i mërzitur”, “jam ngopur me këtë jetë”, ose “nuk jam në qejf të bëjë asgjë” duhet të kuptojnë se gjendja tyre shpirtërore duhet të ndryshoj. Ata duhet pyetur vehtën se ç'ka ndodhur me ta- dhe pse. Allahu e ka dërguar ilaqin: besimin. Ne tash do të egzaminojmë këtë të vërtetë të rëndësishme, dhe në këtë mënyrë nxjerrim në shesh se kur shiqojmë në begatitë shpirtërore dhe materiale vetëm me sytë e besmit shpirti ynë mund vërtetë t'i shijoj ato.

## **Besimi është mënyra e vetme për t'i shijuar begatitë**

Kur'ani konstaton:

**Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen. (Rad 28)**

Me fjalë të tjera, vetëm atëherë kur e kuptojmë mëshirën që Ai ju dhuron shërbyesve të Tij, dhe të besojmë në Të, mund t'a shmangim jolumturinë (hidhërimin) dhe mërzinë, dhe në këtë mënyrë të shijojmë kënaqësinë e vërtetë në këtë jetë dhe t'ia dijmë vlerën e gjërave të mira.

**Atyre që patën frikë nga (dënimi) All-llahu, u thuhet: “ç’është ajo që shpalli Zoti juaj?” Ata thoshin: “Shpalli çdo të mirë!” Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshëmve. (Surja An Nahl 30)**

**148. Ndaj All-llahuua u dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër; All-llahu i do punë mirët. (Al-i Imran 148)**

Por, siç është shpallur në ajetin tjetër, ata që e mohojnë Atë do të kenë një jetë plot me shqetësime (brennga):

**124. E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. (Ta Ha 124)**

Vetëm besimi mund t'na shpëtoj nga jeta me brennga, për çka nuk mund të gjejmë lumturi në vetvete. Edhe nese njerëzit janë të pasur ata nuk mund t'i shijojnë pasurinë apo begatitë që posedojnë. Për t'a bërë këtë, ata duhet të kuptojnë si t'i çmojnë ato. Për shembull, ata duhet të kuptojnë se një karanfil me petale të vendosura në mënyrë të përkryer, si dhe aroma e saj, butësia, dhe bukuria e pakrahueshme, është një begati e madhe e krijimit. Por, vetëm besimtarët munden vërtetë t'a kuptojnë, sepse ata e dijnë se çdo gjë që ekziston është një dhuratë e çmuar nga Allahu dhe se të gjitha begatitë vijnë nga Ai. Prandaj ata e mendojnë (parashikojnë) fuqinë e e Tij të pakufishme krijuese si një gjë shumë të mirë, kështu që e rrisin dashurinë dhe lidhjen e tyre me Atë. Profeti ynë (paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të-pshqt) thot:

*Dujeni Allahun për shkak të begative (të mirave) që ju dhuron, dhe dumni mua për shkak se Allahu më do mua (Al Tirmidhi).*

Allahu me fuqinë dhe forcën e Tij të pakufishme, dhe prej dashurisë dhe mëshirës ndaj njerëzimit, i lejon të gjithë njerëzit t'i shijojnë begatitë (të mirat) në këtë botë. Njerëzit e tillë e shikojnë të zgjimin dhe thithjen e arjit të mëngjesit si begati të mrekullueshme, për çka edhe kënaqen me faktin se Ai ju ka dhënë atyre edhe një ditë t'a fitojnë simpatinë e Tij.

Ata konsiderojnë si burim të lumturisë të qenurit në gjendje të ecin, folin, qeshin dhe të lëvizin, duke e ditur se Ai kishte mundur

tju merr këto begati nëse Ai kishte dashtur t' a bënte këtë. Në këtë mënyrë, ata shijojnë kënaqësi në këtë botë.

Duke e kuptuar se kjo jetë është një periudhë testuese dhe se jeta e vërtetë është jeta e përjetshme që vjen, ata shpresojnë se karakteri i moralit të mirë që ata shfaqin në këtë jetë, si dhe durimi dhe pranimi që ata tregojnë kur t'hasin në fatkeqësi, do t'i shëndrroj ato (durimin dhe pranimin) në begati për ta në parajsë. Për këtë arsye, çdo shqetësim (brendë) që kanë ata në këtë botë bëhet mjet i shpërblimit. Kjo është njëra prej arsyeve se pse besimtarët janë gjithmonë të mbushur me hare, kënaqësi dhe paqe.

Kushdo që mohon Allahun do të përjetoj depresion dhe nuk do të ketë kënaqësi në çfarëdo kënaqësie që ai përjeton, sepse ai e ka larguar vehtën shumë larg nga gjendja e natyrës shpirtërore të shëndoshë që besimi siguron ( pajis, mundëson).

## Kënaqësitë e kësaj bote të humbura nga pabesimtarët

**K**jo jetë është krijuar me begati të cilat thellësisht bëjnë apel tek njerëzit, kështu :

**34. Dhe Ai ju dha gjithatë që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë për përbuzës. (Ibrahim 34)**

Për më tepër Allahu na lejon t'i shijojmë këto begati (të mira) si të dëshirojmë dhe na informon se nëse e falemnderojmë Atë, këto begati do të shtohen edhe me tepër. Sidoqoftë, këto begati të mrekullueshme do të jenë shkak i mjerimit për ata që janë të pafalemnderuar. Kjo është njëra prej sekreteve më të fshehta të Kur'anit, një manifestim i drejtësisë së Allahut, dhe një indikator (tregues) i rëndësishëm i urtësisë së Tij të krijimit. Për ata që shohin Rrugën e drejtë dhe besojnë, Ai vazhdimisht krijon mundësi të reja dhe ju tregon atyre bukurinë e besimit dhe errësirën e jetërave të pabesimtarëve. Pra, çfarëdo begatishë që njerëzit mund t'i kenë nuk mund t'u jep atyre një kuptim të

sigurisë dhe kënaqësisë së vertetëtë. Kjo, në fakt, është mëshirë e Allahut ndaj robëve të Tij, dhe kjo don të thotë se ata mund të kuptojnë se vetëm besimtarët të cilë janë të nënshtuar ndaj Allahut mund të gjejnë lumturinë dhe kënaqësinë e vërtetë, dhe kështu iu nënshtrohen Atij.

Duke i kuptuar rreziqet e mosbesimit dhe bukurinë e besimit, ata të cilët mund t'a shohin urtësinë e Allahut në krijim do të lirohen nga humbjet në këtë botë si dhe nga mjerimi i paimagjinueshëm që kishin për t'a pasur në botën tjetër. Prandaj, lexuesit duhet medoemos t'a kuptojnë çka nënkuptohet me „begatitë shpirtërore dhe mareriale të cilat pabesimtarët i shpenzojnë ( hargjojnë) në këtë jetë (botë). Kjo do të egzaminohet në kapitujt e ardhshëm. Njerëzit të cilët e lexojnë parathëniën dhe shiqojnë titujt e kapitujve mund të mendojnë se ky libër nuk është destinuar për ta për arsye të ndryshme: Ata mund të shijojnë gjërat e mira në këtë jetë, njerëzit e tjerë, natyrën, dhe gjërat e mira të kësaj bote, ose që në njëfarë mënyre ata janë imun ndaj brengës (shqetësimit) dhe depresionit të përshkruar këtu ( në këtë dokument).

Megjithatë, ne kishim pas dëshirë t'u përkujtojmë këtyre njerëzve se bile edhe konsiderimi i nxituar i kësaj qeshtjeje do të sjell dobi për ta. Nëse konsideroni me kujdes këto faqe, do të shihni se me çka kanë të bëjnë, për secilin është një mësim për të mësuar. Disa njerëz mund të mësohen me situatën e tyre me kohën dhe kjo tju duket atyre si gjë normale, duke mos e kuptuar se ata mund të çojnë një jetë të hequr nga shumë kënaqësi dhe begati që Allahu ka krijuar për ta. Arsyeja se pse këta njerëz asnjëherë nuk i kanë shijuar këto kënaqësi është se ata janë kënaqur me kënaqësitë e zakonshme dhe themelore të kësaj jete



dhe mund të besojnë se s'ka kurgju më tepër. Megjithatë, është e mundshme që prej çdo begatie të nxjerret një kënaqësi më e thellë dhe kënaqësi e njerr ndryshon nga personi( individi). Veç kësaj, njerëzit mund të mendojnë se ata tashmë kanë përjetuar mjaftë kënaqësi nga begatitë dhe gjërat e mira të kësaj jete, ose kanë marrë më shumë hise se sa që ju takon. Me fjalë të tjera, ata besojnë se nuk ka nevojë tju përkutojmë. Të tjerët mund të mos kenë përjetuar asnjëherë këtë gëzim më të madh dhe më të thellë brenda vehtës ose me të tjerët për arsye se askush nuk ju ka treguar se gjëra të tilla ekzistojnë. Por tash që janë duke i lexuar këto faqe, Allahu do t'i vetëdijësoj ata për mundësinë e humbjës së begative të tyre në të dy botërat dhe t'u tregoj atyre se si t'a shmangin këtë humbje. Deri në këtë çast, mund të mos kesh qenë në dijeni për këtë çështje. Por tash, pasi ta keni marr këtë dituri, ju do të jeni përgjegjës për t'menduar për të seriozisht dhe të bësh një përpjekje të sinçertë që të kapërcesh (tejkalo)sh) çdo mungesë në të menduarit tënd. Njerëzit mund të mos jenë gjithmonë në këtë gjendje shpirtërore. Por nuk duhet të lejojnë që kjo t'i largoj nga rruga e drejt. Nëse vetëm rastësisht janë të matur (kujdesshëm) me aspektet rutinë (të zakonshme) të jetës, mërzhiten me jetën; dhe mendojnë se jeta ska kuptim, një pakënaqësi e tillë duhet të mjaftoj që seriozisht të marrin parasysh ser çka thuhet këtu. Mbani në mend se harxhimi dhe humbja e kënaqësive në këtë botë është vetëm një fillim i një errësire të përjetshme në jetën tjetër. Në botën tjetër, ky mjerim nuk do të kufizohet vetën në pamundësinë e përjetimit të kënaqësive siç duhet. Duke qenë pabesimtar, njerëzit e tillë do të përjetojnë një mjerim shumë më të thellë. Por, për besimtarë, bota tjetër do të shndërrohet në një begati të përjetshme. Duke e kuptuar gjendjen e pabesimtarëve,

besimtarët mund të shohin ankthin e mosbesimit dhe të mësojnë nga kjo. Si rezultat, ata do të jenë shumë të falemnderuar ndaj Allahut për besimin që ju ka dhuruar. Faqet në vijim do të marrin parasysh humbjën e begatave që shndërron jetën e njëriut në një mjerim të vërtetë, si dhe i përmend kënaqësitë e humbura shpirtërore dhe materiale, dhe në këtë mënyrë nxjerr në shesh jetën e privuar (të mangët nga të mirat- hequr) që pabesimtarët janë të detyruar t'a durojnë (bajnë).

## **Kënaqësitë e humbura materiale**

### **Ata nuk mund të kënaqen me rrethin (mjedisin) e tyre**

Ata të cilët nuk i praktikojnë parimet morale të Kur'anit duken të jenë të anashkaluar me shqetësim ndaj rrethit dhe gjendjes së tyre. Të duhet vetëm një çast për t'a kuptuar se në çfarë gjendje shpirtërore janë ata. Kur ata thonë çdo gjë shkon mirë a mendon se janë të kënaqur, ose çdo gjë është si dëshirojnë ata? A thonë ata se janë të lumtur dhe të ngacmuar me rutinën e tyre të përditshme dhe jetërat e tyre të njejta dhe monotone? Çdo mëngjes zgjohen në të njejtën shtëpi dhe dhomë, rregullojnë të njejtin shtrat, veshin të njejtat rrobe, ecin nëpër të njejtin korridor, hipin në të njejtin autobus, vozitin në të njejtat rrugë, shkojnë në punë të njejtë, dhe ulen në të njejtën karrige në të njejtën dhomë. Gjatë gjithë ditës ata flasin me njerëz të njejtë për gjëra të njejta. A thonë ata se janë të lumtur për bashkëbisedimet e tyre stereotipike?

A thonë ata se janë të kënaqur duke pare të njejtën shtëpi, të njejtat mure, mjedisin e njejtë të punës, dekorin e njejtë, të njejtat mobile me rregullim( vendosje) të njejtë? Apo ndoshta ata

tregojnë se sa të mërziur janë duke ecur nëpër rrugët e njejt duke u takuar me njerëz të njejtë? A ankohen ata se si kjo monotoni ua largon atyre kupimin e jetës së tyre? Përgjigja në këto pyetje është e qartë. Ata të cilët nuk i përcjellin parimet morale të Kur'anit ankohen për mjedisin e tyre të pandryshuar, pikëllohen se çka i ka ngacmuar ata më parë tash nuk ka kuptim dhe joshje (tërheqje), dhe shprehin mërzinë e tyre me monotoninë e jetës, për çka ata më nuk mund t'a shohin bukurinë që i rrethon dhe të shijojnë posedimin e tyre dhe mjedisin. Ky shqetësim (kjo brengë) është aq gjithëpërfshirëse (që i rrethon aq shumë) sa që ata dëshirojnë t'a braktisin qytetin bile edhe shtetin e tyre. Por, besimtarët megjithatë, asnjëherë nuk hasin në një situatë të tillë. Edhe në qoftë se jetojnë në të njejtin qytet gjithë jetën e tyre, kanë të njejtat mobile dhe gjëra personale, dhe bëjnë të njejtën punë, ata janë të kënaqur me gjithçka, se vetëm besimi i tyre në Allahun dhe shpresa për xhenet (parajsë) i bëjnë ata të lumtur. Pamvarësisht nga kjo, megjithatë, nuk është gabim për njerëzit të dëshirojnë ndryshim. Përkudrazi, ky tipar i dëshirës tregon pasurinë e shpirtit njerëzor. Por kjo është krejtësisht ndryshe prej dëshirës së pabesimtarëve për të gjetur ndonjë mënyrë për t'a zbratur mërzinë. Ky dallim së shpejti do të bëhet i qartë.

Padyshim, mjedisi themelor është shtëpia e vet. Kur janë jashtë, disa njerëz nuk mund të presin të shkojnë në shtëpi, duke paramenduar të kalojnë një mbrëmje të këndshme ( mirë) atje. Natyrisht, njerëzit duhet të ndihen të kënaqur, të sigurt, dhe të lumtur në shtëpi, për çka edhe janë në mes të njerëzve që i dojnë dhe besojnë, dhe larg prej botës së jashtme kaotike, të pasigurt dhe paparashikueshme. Për më tepër, shumë njerëz i kanë projektuar shtëpitë e tyre në mënyrë sa më të rehatshme që është

e mundur dhe i kanë zbukuruar për t'u përshtatur në to. Por pavarësisht nga ky mjedis pozitiv, ata të cilët nuk i përcjellin parimet morale të Kur'anit janë të shqetësuar edhe atje.

Kur shpërngulen në shtëpinë e tyre, ata mendojnë se do të kënaqen në çdo cep dhe qosh në të. Por gradualisht, të gjitha mobilet dhe paisjet e tyre që i kanë zgjedhur me aq kujdes, fillojnë t'a humbin kuptimin dhe tërheqjen e tyre. Pas pak, ata më nuk ndihen rehat atje dhe dëshirojnë të ikin diku tjetër për t'iu shmangur ndjenjës së shqetësimit dhe pakënaqësisë. Edhe nëse shtëpia është e gjerë (e bollshme) atyre ju duket e kufizuar (mbyllur), e trishtueshme, e errët dhe e vogël. Ata fillojnë të ndjehen të mërzhitur dhe të shqetësuar (bregosur), duke thënë “kjo shtëpi më ka shtypur”, “këto gjëra më rëndojnë” ose “jam lodhur duke i parë të njëjtat gjëra për çdo ditë” Tash ata nuk kënaqen më në shtëpinë e tyre dhe nuk janë më të ngacmuar të rrinë aty. Njëra prej arsyeve për këtë është se jetërat e tyre janë bërë një rutinë e gjatë të bazuar në standardet e paramenduara (të formuara më herët) të pabesuar të shoqërisë. Çdo gjë është automatike: të gjitha aktivitetet e tyre ditore, prej ushqimit që e hajnë e deri tek programet televizive që i shiqojnë. Larg nga të ofruarit e kënaqësisë, gati të gjitha këto gjëra janë bërë detyrim. Arsyeja tjetër është apetiti i pangopur i tyre për këtë jetë. Kur i krahasojnë begatitë e njerëzve të tjere me ato të vetat, ata bëhen xheloz dhe të mjerë. Duke e kuptuar se dikush tjetër posedon diçka të mirë që ata nuk e kanë, e shndërron çdo posedim tërheqës që ata shohin në një burim të mjerimit për ta. Për shembull, ata mund të nervozohen nëse shtëpia e tyre nuk është luksoze me pamje kah deti, një kopsht me trëndafilat dhe një bazen, ose nëse nuk i ka zbukurimet e fundit. Shqetësimi i tyre

nuk pushon edhe nëse më në fund fitojnë (marrin) atë që lakmojnë, dhe nuk dëshirojnë t'i ndajnë ato me të tjerët. Nëse një shok ose i afërm ju kërkon para (të holla), ata bëhen merak se mos pasuria e tyre do të pakësohet. Ndonjëherë ata frikësohen se do humbin diqka, sepse e dinë se një katastrofë mund t'i godet ata në çdo kohë. Të ndarë nga parimet morale të Kur'anit, ata nuk e marrin parasysh fuqinë e Allahut dhe se çkado që u ndodh atyre vjen nga Ai për t'i testuar (sprovuar). Por, besimtarët asnjëherë nuk vuajnë nga ky shqetësim (kjo brengë), për çka ata janë gjithmonë në dijëni se janë me Allahun dhe se kjo botë është një vend testues (i sprovave) i përcaktuar për të treguar besimin, besueshmërinë dhe nënshtrimin e tyre ndaj Tij. Për këtë arsye ata janë të kënaqur ( pajtohen) me çkado që ndodh dhe me çfarëdo situatë dhe gjendje që Ai ka krijuar për ta, dhe kënaqen me to. Ata demonstrojnë të njejtën gjendje shpirtërore në mjedisin e tyre, pa marrë parasysh se a jetojnë në një shtëpi të vogël verimi, në një shtëpi të madhe apo në një pallat. Atyre nuk u intereson stili arkitektor i ndërtesës, materialet, ngjyrat, madhësia, stili, ose sa gjatë kanë jetuar në të. Të gjitha këto gjëra janë begati për secilin. Megjithatë, besimtarët vendosin rëndësinë në diqka përtej këtyre gjërave, dhe kjo është ajo që i bënë të lumtur dhe të kënaqur: duke jetuar sipas parimeve morale të Kur'anit. Natyrisht ata dëshirojnë që shtëpitë e tyre të jenë sa më të bukura, moderne, të kënaqshme nga estetika që të jetë e mundshme, sepse ata shiqojnë mjedisin e tyre me sytë e besimit. Veç kësaj, pasi që aftësia e tyre për të parë bukurinë dhe për të vlerësuar hollësisht është më e madhe se e shumicës së njerëzve, përshtypja (arsyeja) e tyre për bukurinë, estetikën edhe shumëllojshmëria është më e rafinuar (përpunuar). Por, edhe nëse ka mangësi në atë çka kanë, ata ende i çmojnë dhe

shijojnë ato. Si shpërblim për karakterin e moralit të mirë, Allahu e tregon mëshirën dhe dashurinë e Tij duke iu premtuar besimtarëve prej çdo gjëje më të mirën dhe duke iu mundësuar të nxjerrin një kënaqësi të thellë prej asaj që kanë:

**Dhe (pëkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: “Nëse falënderoni, do t’ua shtojë të mirat, e nëse përbuzni, s’ka dyshim, dënimi Im është i vështirë!” (Ibrahim 7)**

**(ata i luten) që Allhu t’i shpërblejë më së miri për atë që punuan dhe për t’ua shtuar të mirat nga Ai. All-llahu e dhuron pa masë atë që do. (Nur 38)**

**Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xhenneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi as nënçmimi, ata janë banues të Xhennetit, aty janë përgjithmonë. (Junus 26)**

### **Paaftësia e tyre për t’u kënaqur me punë**

Për shkak të gjendjes së tyre shpirtërore të çliruar nga shqetësimet dhe, rrethi vicioz” në të cilin jetojnë, ata pabesimtarë qëllimi i të cilëve është të kenë një jetë të mirë dhe të bëjnë shumicën e begative të tyre e konsiderojnë punën si një telash të madh. Jo vetëm që i lodh ata dhe prandaj i bën të paaftë të jetojnë jetë të mirë gjatë gjithë kohës, por gjithashtu thjesht ju përkujton se sa vështirë është të jetojnë një jetë të mirë. Ideali i tyre është të punojnë më pak dhe kohën e tyre shtesë t’a shfrytëzojnë për t’jetuar një jetë më të mirë. Por, kjo është e pamundur, për çka edhe duhet të punojnë më tepër për t’i realizuar dëshirat e tyre, gjë që iu merr kohën e tyre për t’i shijuar ato.

Duke shiqar me kujdes në jetërat profesionale të atyre që nuk i përcjellin parimet morale të Kur’anit, mund të shohim se, për ta,

puna është bërë një telashe (mudim) dhe një rreth vicioz. Për të mbërrirë në punë me kohë, ata duhet të zgjohen herët, që don të thotë se ata duhet të flejnë herët. Dhe duhet t'a kalojnë (shpenzojnë) tërë kohën për të shkuar në punë, larja, ngrënia, fshirja (pastrimi), kryerja e porosive, dhe plotësimi i të gjitha nevojave të panumërta të jetës së përditshme.

Duke parë se nuk kanë më shumë se ndoshta ca orë për çdo ditë që vërtetë të dëfrehen, ata bëhen nervoz dhe dëshpërohen. Kjo situatë është një burim i madh I pakënaqësisë për ta, sikur që janë brengat dhe vështëritë e zakonshme në jetën profesionale. Negativiteti i tillë fillon gjatë viteve të tyre në universitet, dhe që të gjithë ne kemi ndëgjuar raporte të mediave rreth të diplomuarve të rinj duke ia liruar rrugën dëshpërimit sepse nuk mund t'i kuptojnë qëllimet ose ëndrrat e tyre. Duke mos e kuptuar se gjithqka vjen nga Allahu dhe se është për të mirën e tyre ata shqetësohen dhe brengosen (bëhen merak) rreth asaj se a do të gjejnë punë, nëse do të fitojnë shumë para, përparojnë në karrierën e tyre, dhe çeshtje tjera të tilla. Këta njerëz nuk e kuptojnë se çdo gjë ndodh nën kontrollin e Allahut dhe kështu, iu duket shumë e lodhshme dhe e mërzitshme të shkojnë prej një dere në një derë për të kërkuar punë dhe të jenë të refuzuar. Dhe mbas të gjitha përpjekjeve të lodhshme, ata mbarojnë duke pranuar një punë që nuk e dëshirojnë. Ata nuk janë në gjendje të gjejnë një punë për të cilën kanë ëndërruar në ditët e tyre në univerzitet. Dhe në vend se të sigurojnë ndonjë pozitë (post) që ata e dëshirojnë, ata janë të detyruar të pranojnë një punë që nuk i tërheq. Për shkak se nuk mundën të kryejnë detyra për të cilat kanë shpresuar dhe panifikuar, punë e alternatives (zgjedhjes) dytësore të tyre bëhet një punë e rëndë (angari) dhe e

papërshtatshme për ta. Pa marrë parasysh se sa të lodhur janë, ata duhet të shkojnë në punë (edhe nëse nuk iu pëlqen, ata duhet të fitojnë para), ku ata do të jenë jo të lumtur (bregosur). Veç kësaj, ata shpesh duhet të udhëtojnë përmes trenit, borës dhe pellgjeve të baltës (lloçit) për t'ua zënë autobusin për punë. Ata duhet të presin në rresht që ai (autobusi) të vie, duke u djersitur në nxehtësi gjatë verës/verave dhe duke u mbërdhirë në të fohitit e dimrit. Situata nuk ndryshon aq shumë për ata që shkojnë në punë me vetura. Tash ata duhet të presin me orë të tëra të bllokuar në komunikacion dhe shpesh fillojnë të grinden me shofera të tjerë thjesht nga padurimi (zemërimi). Sapo të mbërrijnë, mjedisi i tyre i punës është një burim tjetër i stresit për ta. Por ata, si kushdo tjetër fillojnë punët e tyre të reja me shpresa të mëdha për të fituar (merituar) një rrogë të mirë dhe për t'u shpërngulur në një lagje më të mirë. Por, jeta e rehatshme, e sigurt e lumtur e punës për të cilën kanë shpresuar së shpejti mbushet me shqetësime. Sikur në të gjitha situatat ku parimet morale të Kur'anit nuk praktikohen, ata shohin një mjedis me besdisje, grindje, xhelozë, dhe hidhërime të përgjithshme. Dhe kështu ata mundohen të gjejnë pretekst për t'u grindur me bashkëpunëtorët e tyre, bëhen xheloz me ata që janë në pozita më të larta, dhe i nënçmojnë (turpërojnë) ata që janë në pozita më të ulëta. Sekretarët, menagjerët dhe drejtorët garojnë më njëri-tjetrit, dhe kështu nuk mund të bëhen shokë. Nëse dikush tjetër caktohet (emërohet) në një punë (detyrë) të cilën ata e kanë dëshiruar, ata irritohen dhe mendojnë se janë trajtuar në mënyrë jo të drejtë. Fyerja e tyre ndaj bashkëpunëtorëve të tyre e posaçërisht ndaj drejtorëve dhe menagjerëve rritet, dhe së shpejti ata ngopen me punën e tyre, janë të pakënaqur dhe të mërzitur. Atyre nuk ju pëlqen të jenë në



të njejtin post (pozitë), duke parë të njejtin njerëz dhe duke u dashtur të punojnë shumë në një rreth që ata e përbuzin dhe kjo vazhdimisht ua humb durimin. Si rezultat, niveli i tyre i lodhjes, stresit dhe mjerimit (jolumturisë) rritet. Por situata në të cilën gjejnë vehtën këta njerëz terësisht rrjedh prej ideve të gabuara në të cilat ata i kanë bazuar jetërat. Natyrisht, njerëzit duhet të punojnë ndonjë punë që do t'iu lejoj (mundësoj) të fitojnë mjaftueshëm për të mbijetuar. Dhe është fare e natyrshme që ata do të përjetojnë një varg të vështërsive që puna e tyre u sjell. Qeshtja, megjithatë është se vështërsitë që çdo punë dhe mjedis punues paraqesin do të bëhen burime të irritimit (frustrimit) për njerëzit ignjorant, thjeshtë për shkak të gjendjes së tyre shpirtërore.

Për shkak se që të dy; ata dhe ata që i rrethojnë jetojnë të ndarë nga mësimet e Kura'nit për parimet e moralit, dhe për shkak se ata i shiqojnë jetërat dhe ngjarjet e tyre nga pikpamja caktuar e tyre, çdo gjë iu duket më e vështirë dhe e dështuar (zhgënjyese). E njejta është e vërtetë edhe për ata të cilët nuk mundohen shumë për të gjetur një punë të mirë dhe që paguhet, për të kryer një punë që dëshirojnë, dhe të sigurojnë një pozitë të mirë në karrierën që kanë zgjedhur. Edhe nëse arrijnë një standard të mirë jetese, asnjë sasi e pasurisë materiale nuk mund t'a mbush zbrasëtinë në zemrat e tyre. Ata përjetojnë gjendjen e njejtë të shqetësimit shpirtëror. Ata jetojnë një jetë me pakënaqësi sepse janë të lidhur për kësaj bote me aq passion, sa që ata mbesin ambicioz për pasuri dhe posedim (zotërim), dhe konsiderojnë çdo gjë dhe çdokend rreth tyre thjesht si një mundësi tjetër për përfitim personal.

Në fakt, burimi kryesor i shqetësimit të tyre vjen nga të

shiquarit e problemeve pa i marr parasysh parimet morale të Kur'anit. Frustrimi (zhgënjimi) i tyre është “shpërblim” i Allahut për mosbesimin e tyre kokëfortë. Ata ignjorojnë begatitë e tyre dhe nuk iu falemnderohen Atij për to, kështu iu çon atyre shqetësime. Sikur të mos ishin konsumuar (shkatërruar) me pasion për këtë botë, sikur t’u kishin çmuar ate çka kanë dhe t’u kishin falemnderuar Atë për to, ata do të ishin në gjendje të shijonin posedimin (zotërimin) e tyre.

**Le të qeshin pak (në dynja) e le të qajnë shumë (në botën tjetër). Ai është shpërblim i asaj që fituan. (Teube 82)**

**E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. (Ta Ha 124)**

Kur njerëzit përcjellin parimet morale të Kur'anit nuk ndihen të shqetësuar apo të mërzitshëm. Megjithatë, kënaqësia e nxjerrë nga bërja e diqkaje duke pasur në mend qëllimet e kësaj bote është shumë e kufizuar dhe zgjatë shkurt. Kur përfitimet e fituara zbrazen, egoja e tyre për të vazhduar fundoset dhe qëllimi konsiderohet si një bezdi (mërzi). Por, ata që kërkojnë përkrahjen e Allahut shpërblehen me kënaqësi, për çka ata e dinë se do të shpërblehen për qëllimet e tyre dhe jo për natyrën e veprës. Prandaj, kurrë nuk dot mërziten kur e bëjnë atë (veprën):

**te All-llahu nuk arrin as mishi as gjaku i tyre, por te Ai arin bindja e juaj. Ai ashtu ua nënshtroi ato juve që ta madhëroni All-llahu për udhëzimet që ua bëri. Bamirësëve merru myzhde. (Al Haxh 37)**

Dhe kështu, pa marrë parasysh se çka bëjnë, nëse e bëjnë ate duke shpresuar për t’fituar kënaqësinë e Allahut, dhe nëse vazhdojnë t’u bëjnë këtë deri në përfundim të jetës së tyre, kurrë

nuk do të mërzhiten ose t'a humbin kënaqësinë për t'a bërë ate vazhdimisht. Pa marrë parasysh se sa gjatë e bëjnë atë vepër, dashuria dhe dëshira e tyre për t'fituar kënaqësinë e Allahut do t'i bëjë ata që vazhdimisht të formojnë gjëra të reja dhe të bukura në horizontin e tyre. Duke i rrënjosur parimet e tyre morale në frikën ndaj Tij, ata formojnë marëdhënie dhe shoqëri të ngushtë me ata përreth tyre; s'dëshirojnë gradë, pozitë, ose para: dhe asnjëherë s'janë xheloz apo të mërzhitur.

### **Ata nuk mund të kënaqen nëpër qendra për zbavitje**

Disa njerëz që janë lidhur me këtë botë, e dinë se jeta është e shkurtë dhe dojnë të shfrytëzojnë sa më shumë që kanë.

Nuk ka asgjë të keqe këtu, por Allahu e ka paisur këtë botë me aq shumë gjëra të mira, që të mund të kënaqemi me to dhe t'a falemnderojmë Atë (Allahun). Megjithatë, pabesimtarët mendojnë se mund t'i fitojnë këto gjëra të mira përmes mënyrave (mjeteve) Jo-Kur'anore dhe atëherë të kënaqen me to. Duke i përdorur metodat e tyre, ose teknikat që përdoren përgjithësisht në shoqëri, ata supozojnë (marrin me mend) se mund t'i shijojnë kënaqësitë më të mira që jeta e kësaj bote ju ofron. Njëra nga këto metoda është "zbavitja (argëtimi)". Por pasi që ata e definojnë zbavitjen në bazë të stilit të tyre jetësor dhe karakterit moral, nuk mund t'a shijojnë si duhet, për këtë:

**Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen. (Ar Rrad 28)**

Pavarësisht nga kjo, nuk ka gajle (lidhje) çka bënë një person. Edhe në qoftë se ai zbulon zbavitjet më të mira dhe me plotë

ngjyra në Tokë, ai kurrë nuk do të jetë në gjendje të kënaqet në ndonjërin prej tyre. Nëse shiqoni me kujdes llojet e zbavitjeve që njerëzit injorant i kërkojnë, prapë do të shihni dëshpërimin në të cilin hulumtimi (kërkimi) i tyre e arrin kulminacionin. Ata të cilët nuk i përcjellin parimet morale të Kur'anit kanë një ide shumë të kufizuar të zbavitjes. Ata i kanë bazuar jetërat e tyre në pritjet (shpresat) e të tjerëve në një shoqëri injorante, të etur për t'fituar një pozitë të mirë në mesin e tyre dhe të fitojnë respektin e tyre. Si rezultat, në çështjet e zbavitjes, ata lufotjnë (përpiqen) të përshtaten në një humus (myk) të cilën shoqëria tashmë e ka ndërtuar ose aprovuar, me tepër se sa të kërkojnë kënaqësitë në mënyrë të pavarur (vetë). Nëse lehen në zgjedhjet (alternativat) e tyre, shumë njerëz të cilët kërkojnë zbavitje të, popullarizuar “ shumë më përpara do t'a kalonin kohën e tyre në shtëpi duke shiquar televizorin, duke ngrënë ushqim të mirë, duke shiquar pamje të bukura, ose duke folur me shokë ose me njerëzit e tjerë. Por, pa marrë parasysh se sa mund t'i kënaqin këto argëtime, ata nuk e lejojnë vehtën të kënaqen me to, më qëllim që t'i transmetojnë dhe t'fitojnë respekt. Dhe kështu shkojnë ku shkojnë të gjithë për t'u zbavitur, dhe zgjedhin format e njejtë të zbavitjes. Prandaj, pabesimtarët mundohen të gjejnë kënaqësi duke dalë për darkë me shokë, duke shkuar në teatër ose kinema, duke shkuar (vijuar) në aktivitetet shoqërore nga shkolla e tyre apo kolegët tyre profesional, duke diskutuar në kafe, ose duke shkuar në ndonjë klub për të vallzuar ose ndëgjuar muzikë. Natyrisht, disa individë mund të kënaqen me këto shetitje (dalje). Por, për t'u kënaqur në mënyrë të drejtë, ata duhet t'a kenë frikë dhe t'a respektojnë Allahun, të besojnë në Të, dhe të kenë një karakter të moralit të mirë. Përndryshe, të gjitha këto shansa të

mira thjeshtë do t'i merakosin (shqetësojnë) ata. Ato i shpiejn njerëzit në një mjedis (rreth) ku do të jenë të ndikuar nga detyrimi i një parimi moral (virtyti) injorant. Pra kur ata të cilet janë larguar shumë nga parimet morale të fesë të bashkohen, bëhet e çartë se sa e kanë shpërfillë këtë realitet.

Siq e pamë më lartë, së pari të larguar, njerëzit injorant veprojnë më tepër sipas kërkesave të shoqërisë së tyre, se sa që i përcjellin shijet dhe prirjet e tyre. Për sa i përket asaj se si do të zbavitën, çfarë filmash do të shiqojnë, dhe në cilat restorante, kafene apo klube nate do të dalin, ata i bazojnë vendimet në standardet e shoqërisë së tyre. Ata mendojnë se duke bërë gjëra elegante dhe të modes që shoqëria ju aprovon (pëlqen) do t'u fitoj atyre pozitë, rëndësi dhe respekt në sy të të tjerëve. Për shembull, të shihen në ndonjë klub nate të popullarizuar “ku të gjithë shkojnë” është shumë me rëndësi për vetërespektin e tyre. Edhe nëse nuk ndihen të rehatshëm atje, të nesërmën duke qenë në gjendje t'u tregojnë kolegëve ose shokëve se kanë kaluar mirë në një vend të popullarizuar, ju lejon atyre që të jenë në qendër të vëmendjes. Kur shiqojmë këto vende të zbavitjes, shohim se asgjë në to nuk i apelon shpirtit njerëzor, aq më tepër i bëjnë njerëzit të lodhur dhe të shqetësuar. Shumica e këtyre vendeve janë përplot me njerëz dhe air të ndotur, për shkak se shumë njerëz pijnë duhan.

Për shkak të zhurmës nuk mund t'i ndëgjojmë të tjerë çka thojnë. Pa marrë parasysh se sa e mire është muzika dhe sa i shijshëm është ushqimi, turma (grumbulli i njerëzve-kallabllaku) e bën të pamundshme të kënaqemi me to. Edhe në qoftë se ky vend do të ishte gjallërues, i ndritshëm, i pastërt, dhe i paisur mirë, rezultati prap do t'ishte i njëjtë, sepse njerëzit të cilët

shkojnë atje nuk i përcjellin parimet morale të Kur'anit prandaj edhe nuk janë të kënaqur. Në një ambient (rreth) të mbushur me lakmi dhe rivalitet (konkurrencë), njerëzit nuk mund të kënaqen. Kjo mund të ndodhë vetëm në një rreth natyral, të ngushtë, shoqëror dhe të sigurt. Megjithatë, vështirë se do të jenë të kënaqur nëse ata vazhdimisht shiqojnë gabimet e të tjerëve dhe i nënçojnë njerëzit e tjerë duke dhënë kritika për të metat e tyre. Është e qartë se njerëzit që shoqërohen me njëri-tjetrin kryesisht për të shfryrë lakminë (xhelozinë) dhe konkurrencën e tyre nuk mund të kënaqen me asnjërin prej hiseve të tyre në ushqim, bisedat e tyre, duke ndëgjuar muzikë së bashku ose duke vallëzuar. Në vend të kësaj ata do të lodhen, në të dyja aspektet: shpirtërore dhe fizike. Ky është një fakt që edhe vetë ata nuk mund t'a mohojnë. Përveq kësaj, bota në të cilën këta njerëz injorant shoqërohen është e hapur ndaj të gjitha llojeve të rreziqeve. Pa marrë parasysh se sa me kujdesë ata sigurohen të zgjedhin zbatimjen a kualitetit me të lartë, se a ju pëlqen a jo, janë të detyruar të durojnë një shoqëri njerëzish nga segmentet e një shoqërie krejtësisht ndryshe nga e vetja. Këta njerëz mund të kenë qëndrime të çoroditura, të kaluara të errëta dhe personalitete kriminele; ata mund të jenë të dhënë pas alkoolit dhe drogës. Kjo, natyrisht mund të krijoj atmosferë të tensionuar për ata që dëshirojnë vetëm të kënaqen. Prandaj, duke qenë në një shoqëri njerëzish që nuk e njohin – për të kaluarën, stilin jetësor, karakterin moral dhe personalitetin e të cilëve dijnë aq edhe më pak, e bënë të pamundur të rehatohen mirë dhe të kënaqen. Njerëzit nuk mund të ndihen të sigurt në një ambient (rreth) të tillë, sepse asnjëri prej tyre nuk e respekton dhe nuk ka frikë nga Allahu. Ata nuk brengosen se do duhet të japin llogari para

Allahut në jetën e përtejme (ahiret), dhe këhtu mendojnë, sillen, ragojnë sipas dëshirave dhe parimeve të tyre; ignjorojnë të gjitha porosinë (këshillat) dhe kufijtë përveq për mendimet e tyre, dhe kërkojnë dobi (hair). Për t'gjitha këto arsye, është e pamundshme të ndihen vërtetë të sigurtë dhe të rehatshëm kudo që takohen njerëzit që nuk kanë besim në Allahun. Si mund të kënaqet dhe të çlodhet dikush në një mjedis kaq të rrezikshëm dhe të tensionuar? Për më tepër, edhe pse e dinë se nuk mund të kënaqen si të dojnë, nuk e kuptojnë se problemi u vjen nga mungesa e besimit. Ata mundohen të gjejnë zgjedhje në forma tjera të zbavitjes, por pa sukses. Pa marrë parasysh se ku shkojnë, ndeshen me të njejtin shqetësim, tension dhe mërzë. Edhe pse nga pikëpamja e një vëzhguesi duken sikur kënaqen, prej asaj që kemi thënë është e qartë se ata nuk mund të gjejnë dot kënaqësi dhe qetësi shpirtërore.

Allahu tërheq vemendjen tonë në këtë fakt:

**4. Rreth argumenteve të All-llahut nuk kundërshton kush, pos atyre që nuk besuan; pra ty të mos te mashtrojë lëvizja e tyre nëpër qytete. (Surja Gafir 4)**

**Të mos mashtrojë bredhja nëpër qytete e atyre që nuk besuan. Ajo është një kënaqësi e pakët, e pastaj vendi i tyre është Xhehennemi që është vend mjerimi (Ali Imran 196-197)**

Allahu iu çon pabesimtarëve këtë mjerim dhe nuk i lejon të kënaqen kështu që të jenë të shkatërruar (konsumuar) me dëshpërim. Nëse besimtarët e gjejnë vehtë në një mjedis të ngjajshëm, ata mbesin të kënaqur duke qenë në dijeni se ata kanë frikë Allahun dhe se përcjellin parimet morale të Kur'anit.

### **Ata nuk mund të kënaqen me ( shijojnë) pushime**

Pabesimtarët mendojnë se duke shkuar në pushime mund t'i ikin jetërave të tyre të pakëndshme. Nëse nuk janë në gjendje t'a bëjnë këtë, njerëzit në gati çdo segment të shoqërisë kërkojnë t'i krijojnë vehtës një mjedis pushimi, në bazë të shijeve dhe të ardhurave të tyre materiale. Disa prej tyre qëndrojnë në shtëpi dhe pushojnë: disa të tjerë shfrytëzojnë rastin në ndonjë kohë të lirë dhe bëjnë një gjiro (udhëtim) ditore. Edhe pse zgjedhjet e tyre se ku të shkojnë mund të jenë të ndryshme në thelb, qëllimi i përbashkët i tyre është të marrin pushim në punën që ishin dashur t'a bëjnë gjatë tërë vitit dhe t'a kalojnë kohën duke u kënaqur më shumë duke bërë diçka krejtësisht ndryshe. Dhe kështu' ata fillojnë të kursejnë para, duke ëndrruar për pushimet e tyre të ardhshme. Ata paraprakisht planifikojnë çdo detaj; zgjedhin me kujdes rrobat që për t'i veshur dhe sigurohen se kudo që kanë për të qëndruar të kenë gjithçka që u nevojitet për t'a ndier vehtën të rehatshëm. Dhe në mënyrë që në kohën e tyre të kufizuar të kënaqen sa më shumë ata shpesh bëjnë përgatitjet që edhe shokët e tyre të mirë të shkojnë me ta. Dhe prapë, shpeshherë asgjë nuk ka nga këto plane, pushimi nuk del siç është pritur. Nganjëherë, njerëzit kthehen bile edhe më të lodhur fizikisht dhe psikikisht se sa kanë qenë para se të shkojnë. Ka arsye të caktuara për këtë. Për shembull, Allahu i teston njerëzit duke krijuar fatkeqësi të dukshme (qarta) si dhe disa mjedise që bëjnë apel në unin e tyre më të ulët;

**çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e NE, në shenjë sprove ju sprovovmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne. (surja Enbija 35)**



Pra, sipas urtësisë së Allahut qëniet njerëzore përjetojnë gjëra të këndshme dhe të pakëndshme gjatë rredhës së jetës së tyre. Nëse demonstron karakter të moralit të mirë përballë fatkeqësive, ngjarjet që në shiqim të parë janë dukur si negative, të vështira Allahu i shndërron në mjete për diçka të mirë dhe pozitive. Prandaj, kushdo që vepron nga kjo pikëpamje do të jetë i kënaqur në çdo moment të jetës së tij. Ai do t'i çmoj gjërat e mira që i ka dhe do të jetë i lumtur me to. Por një person me një karakter të moralit ignjorant duke hasur në këto situata të lodhshme që Allahu ka krijuar, nuk do të sheh asgjë të mirë në këto ngjarje në dukje negative. Ai do të jetë larg nga të qenurit i kënaqur me to, dhe për shkak të qëndrimit të moralit zemërak, nuk do të jetë në gjendje t'i shijoj (kënaqet me) gjërat e mira që posedon (ka).

Në mjediset ku mungojnë parimet e larta të moralit të realizuara nga frika prej Allahut, njerëzit nuk mund të jenë të kënaqur me vetvetën, as që munden ata të kënaqen me gjërat e mira që u ofrohen. Kjo është sepse aty ku nuk ka besim në Allahun, kur nuk ka mundësi të shihen t'mirat në çdo ngjarje, asnjëra nga fazat e pjekurisë nuk është nevojitur për t'i duruar qëndrimet dhe fatkeqësitë e qarta. Dhe aty kujtë njerëzit nuk mund t'i zgjedhin problemet duke mposhtur (anashkaluar) hidhërimin, një qëndrim injorant i pushton (kaplon), duke i nënshtruar ata ndaj një shqetësimi të madh.

Pra, kjo është një nga arsytet pse disa njerëz nga pushimet e tyre nuk mund të nxjerrin kënaqësinë e pritur pavarësisht përpjekjeve të tyre më të mëdha. Dhe kështu është edhe me aspektet e tjera të jetës së tyre. Nëse ishin dhënë disa shembuj të shkurtër të problemeve që sipas gjasave mund t'i hasnim në këto shetitje, atëherë do t'ishte e qartë se këta njerëz ndihen jo të

lumtur vetëm për shkak të karaktereve të moralit të tyre. Në çdo mjedis të pushimit, dëshprërimi që më së shpeshti haset është se vendi ndryshon nga ai që ata kanë pritur të jetë. Fakti që vend strehimoret- banesat janë më të vogla se sa që kanë paramenduar ata mjafton tu prish atyre kënaqësinë që në fillim. Kësaj shtoja edhe atë se ata mund t'a kenë pasur një udhëtim të vështirë për të mbërri atje, duke i bërë veçanërisht të padurueshëm. Pakënaqësia e tyre e të qenurit në një vend të panjohur që ata nuk dëshirojnë vetëm se i shton paaftësisë së tyre për të toleruar mungesën e komoditeteve apo paisjeve, duke i bërë ata të ndihen plotësisht të dëshpërruar. Të shtuarit në jolumturinë e tyre është një ide paragjyquese se çdo gjë që fillon keq do të vazhdon në të njejtën mënyrë. Ndonjëherë gjejnë situata krejtësisht sipas shijës (qefit) së tyre. Por, po qe se edhe një gjë e papritur u ndodh atyre gjatë pushimit të tyre, e tërë kënaqësia e tyre zhduket. Për shembull, ata shkojnë diku për të bërë banjo dielli dhe fillon të bjerë shi, nuk ka rrymë apo ujë rregullisht, bazeni është përplot me njerëz, ose nuk kanë mbetur tavolina të mira në restaurant. Besimtarët të cilët hasin në të njejtat situata, megjithëate, i shohin ato nëpërmes syve të besimit si burime të kënaqësisë. Pa marrë parasysh se sa e papëlqyeshme një situatë mund të jetë, do të shohin shumë gjëra për t'cilat do t'i falamnderohen Allahut dhe dot dijnë si t'jenë të kënaqur me to. Për shembull, moti mund të mos jetë me diell, por ka gjëra tjera interesante për t'bërë kur bjen shi. Ose, bazeni mund të jetë përplot me njerëz, por ata mund të angazhohen në sporte të jashtme (psh jasht shtëpisë), në ekskurzione, apo të bëjnë pazar. Tavolina në restaurant mund t'mos jetë më e mira, por në tavolinën tjetër ka shokë me të cilët mund të bisedojmë. Ata mbesin të qetë në t'gjitha situatat e përmendura më lart, dhe

reagimi ndaj tyre në mënyrë negative vetëm se i bënë ata të mjerë. Duke e ditur këtë, ata përvetësojnë një qëndrim të matur dhe pozitiv ndaj rrethanave të tilla. Në fakt, pabesimtarët s'janë të lumtur edhe kur gjinden në një mjedis të përkryer, për shkak se prishja e tyre shpirtërore, pakënaqësia e mbrendshme, dhe karakteri i moralit Jo-Kur'anor i pengojnë ata t'i shijojnë ato begati. Nëse ata nuk dijnë se si t'a falemnderojnë Ate (Allahun) për atë çka kanë ose si të shiqojnë pozitivisht në çdo gjë që ndodh, në qoftë se janë jotolerant dhe nuk falin gabimet e njerëzve të tjerë, dhe nëse nuk janë dorëlibër dhe modestë, kurrë nuk do të jenë në gjendje të shijojnë ndonjë begati të Tij. Por, në qoftë se në zemrat e tyre kanë frikë dhe respekt për Allahun, ata do t'i kenë të gjitha këto vlera të moralit dhe Allahu do t'u mundësoj atyre të përjetojnë kënaqësitë e kësaj jete.

### **Duke qenë të mërzitur me ate që kanë**

Allahu na tregon në Kur'an se të mirat nuk u bëjnë mirë (hair) pabesimtarëve:

**Andaj, ti (Muhammed) lëri ata edhe një kohë në atë mashtrimin e tyre. A mos mendojnë ata se me atë që jemi duke udhënë atyre nga pasuria dhe fëmijët, Nxitojmë t'u ofrojmë atyre të mirat? Jo, kurrësesi, por ata nuk janë kah e kuptojnë. (Mu'minin 54-56)**

Pabesimtarët mund t'a kalojnë jetën të rrethuar me pasuri, bukuri, nder, famë dhe respekt. Pos asnjëra nga këto gjëra nuk u bënë mirë apo të bëhet begati për ta, dhe ata do të përjetojnë vetëm rritje të agonisë në të dy botërat. Në pamje të jashtme duket se Allahu u jep begati, por Ai nuk iu mundëson të kënaqen me to. Prandaj, edhe pse t'gjitha begtatitë janë perreth tyre megjithëate

ata janë të privuar nga ato. Njeriu mund të ketë çdo gjë që dëshiron por bëhet një mjerim për të të mos jetë në gjendje të kënaqet me ate që tashmë e ka. Ne duhet mbajtur në mend se ata e dinë arsyen e kësaj, dështimi i tyre për të vepruar sipas vlerave të Kur'anit. Natyrisht, ata e mohojnë këtë me vull. Dhe në vend se të kërkojnë zgjidhje në besim dhe të gjejnë strehim te Allahu, ata mundohen t'i ikin mërzisë së tyre duke ndrruar zakonet (adetet), qëndrimet, rrethet shoqërore, shokët dhe vendet që frekuentojnë ata. Ata shpresojnë se atëherë, përsëri çdo gjë do të jetë në rregull, dhe do t'i kenë kursyer jetërat e tyre nga zbrazëtia dhe zemrat e tyre nga shqetësimi. Të gjithë ne i kemi ndëgjuar njerëzit përreth nesh duke thënë gjëra si në vijim; “dua të filloj një jetë të re”, “do t'ia filloj nga zeroja” dhe “do t'a fshij të kaluarën dhe do t'a shfletoj një faqe të re”. Edhe nëse ia dalin të follojnë jetëra terësisht të reja ata megjithëate nuk mund t'a gjejnë kuptimin, ngacmimin, ose lumturinë të cilën e kërkojnë. Për shembull, ata ndjekin ligjëratat për artin e pikturimit apo skulpturës, duke menduar se do t'iu jep kënaqësinë për t'krijuar punët e artit që shprehin personalitetin e tyre. Por ata se shpejtë zbulojnë se çfarëdo kënaqësie e tillë nuk do të vie (nuk është e ardhshme). Ata provojnë çdo gjë për të nxitur egon (unin) e tyre, gjejnë lajkatim (admirim) në mesin e moshatarëve të tyre, dhe t'fitojnë një reputacion të mirë në shoqërinë e tyre. Ata janë të pranishëm në mbledhje, pranojnë një pozitë në një organizatë bamirësie, shkojnë në ekspozita, koncerte dhe teatra; ata shkojnë për t'bërë pazar, provojnë lloje të ndryshme të sporteve, dhe caktojnë mbledhje me shokët e tyre. Por, pas një kohe të shkurtë mërziten edhe me këto gjëra; ata nuk mund të gjejnë ngacmimin (interesimin) të cilin janë duke e kërkuar. Kurgju nuk ka

ndryshuar sepse as shpirti i tyre nuk ka ndryshuar. Vetëm nëse këta anëtarë të shoqërisë injorante i braktisin këto veti (karakteret) të pahijshme dhe përvetësojnë parime të larta të moralit për të cilat Allahu ka urdhëruar ata mund të jenë të lumtur dhe të kënaqur. Disa mendojnë se paret dhe ate çka mund të blejnë me to i bëjnë ata të lumtur dhe kështu koncentrohen në fitimin e saj. Por, duke fituar një veturë më të mirë, një shtëpi më të mirë, një pozitë më mirë, më shumë komoditet asnjëherë nuk do t'i kënaq ata, për këtë ata janë të mbushur me dëshirë për të pasur edhe më shumë. Për shembull, disa njerëz kanë pasion veturat. Është shumë me rëndësi që vetura e tyre të jetë markë e mirë dhe modeli më i fundit; duhet t'a ketë teknologjinë e mirë dhe sistemin kualitativ të muzikës. Ata bëhen lidhen shumë emocionalisht me automjetin e tyre dhe skanë dëshirë që ajo të ketë as edhe dëmin dhe gërvishjen më të vogël. Por kënaqësia e tyre për të vozitur një veturë të mirë nuk zgjatë shumë. Së shpejti del një model i ri, dhe ai i tyre bëhet i dalë nga moda (i vjetëruar). U dhemb të lexojnë se tash në treg është një automjet më i shpejtë me më shumë paisje shtesë dhe me teknologji më të avancuar dhe në një moment të menjëhershëm humbin tërë kënaqësinë për lakminë që kanë pasur dikur. Për njerëzit injorant edhe dollapi i rrobave bëhet një problem i madh. Disa njerëz kanë dëshirë të përcjellin modën më të re të rrobave, edhe pse mund të mos kenë para të mjaftueshme për t'a bërë këtë. Ata blejnë një kostum që u pëlqen dhe që u duket tërheqës, por ndalojnë së pëlqyeri kur del prej mode apo kur t'a shohin të veshur në dikend që nuk e dojnë, ose edhe më keq kundërshtar (konkurrent). Befas, kostumi e humb joshjen dhe bëhet burim i irritimit. Në mënyrë të njejtë, duke parë dikend se ka veshur rrobe më të mira se ato që i kanë ata, i bënë

ata, mjaft të mjeruar. Pa marrë parasysh se sa të mira janë kostumet e tyre, ata brengosen se nuk janë më tepër se të zakonshëm, gjë që i bënë ata jo të lumtur. Zakonet e tyre, aktivitetet shoqërore, mjetet materiale, ose ato që kanë nuk do t'i bëjnë të lumtur, dhe kërkimi i tyre i vazhdueshëm për më shumë, i bënë ata edhe më të mjerueshëm. Kur t'a kuptojnë se ata me të vërtetë kanë shpenzuar dhe humbur të gjitha kënaqësitë e kësaj bote, në përgjithësi ata bëhen nervoz me jetën". Duke mos dashur t'i zgjidhin problemet e tyre nëpërmes besimit, ata ngecin në hutim dhe hidhërim (Jo lumturi). Prandaj, pavarësisht nga përpjekjet e tyre ata mbesin të hutuar dhe të palumtur. Megjithatë, nëse ata do t'i kishin praktikuar parimet morale të fesë, do t'kishin një kënaqësi më të thellë se sa që kishin mund t'a paramendojnë. Besimtarët e shohin këtë në jetërat e tyre në mënyrë të qartë. Duke ikur nga mërzia dhe shqetësimi, ata gjejnë shpirtërat e tyre duke u thelluar për çdo ditë e më shumë dhe kështu fitojnë një mirëkuptim edhe më të madh të vlerave të begative që Allahu iu dhuron. Dëfrimi dhe kënaqësia e tyre rritet, kështu që ata e kuptojnë se këto begati janë manifestime të mëshirës së Allahut, dashurisë dhe mirësisë ndaj tyre. Për shkak se jetojnë jetërat e tyre krejtësisht për Allahun, përdorin çdo avantazh të tyre për t'fituar përkrahjen (simpatinë) e Tij, dhe bëjnë gjithçka për t'a kënaqur Ate, ata vazhdimisht përjetojnë të njëjtin gëzim dhe eksitim. Në Kur'an Allahu vazhdimisht nxjerr në shesh gjendjen e qetësisë shpirtërore të qëndrueshme të atyre që besojnë në Të:

**O shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt i kënaqur (për vehte) e kënaqës (për Zotin)! Hyr mes robërve të Mi! Dhe hyr në Xhennetin Tim! (Surja Fexhr 27-30)**

### **Ata nuk mund të kënaqen me bukurinë e natyrës**

Mënyra materialistike e t'menduarit të pabesimtarëve i pasqyron ata si t'paaftë për t'a kuptuar (ndjerë) bukurinë e natyrës. Gati çdo gjë rreth tyre ata e shohin sa i përket asaj se s'i mund tu sjell dobi dhe si mund të bëjnë më shumë në këtë jetë. Ky kërkim për dobi është aq shumë një pjesë e karakterit të tyre sa që ata mendojnë se diçka mirë ka kuptim vetëm nëse u sjell lajkatime dhe respekt. Ky vizion i kufizuar i pengon ata të shohin të gjitha bukuritë e natyrës duke zbuluar çdo pjesë të krijimit, dhe kështu vlerësimi i saj nga ana e tyre është vetëm sipërfaqësor.

Por, Allahu e ka paisur (furnizuar-mbajtur) gjithë tërë botën me bukuri madhështore të natyrës për t'a kënaqur shpirtin njerëzor dhe kështu të mendojmë për Të, të shohim fuqinë e madhe të Tij, t'besojmë në Të, dhe t'a falemnderojm Ate. Pa marrë parasysh se ku jetojmë, të gjithë ne kemi ndojnjë lidhje ngapak me këtë bukuri. Shiu, valët që godisin bregun, një perendim dielli, ose pamja e një luleje që nis të lulëzoj, që të gjitha këto japin një kënaqësi shpirtit të njeriut. Të gjitha pjesët e krijimit lënë një përshtypje tek njerëzit dhe u sjellin atyre begati. Duke shiqur me sy të besimit, besimtarët e dinë se të gjitha këto gjëra të bukura Allahu i ka krijuar për ta. Dhe në këtë mënyrë ata shiqojnë çdo hollësi të tyre më të mirë dhe nga ato nxjerrin një kënaqësi të thellë. Ata që e vështrojnë botën me sy të pavëmendshëm e shohin atë nëpërmes një perdeje të pavëmendshmërisë. Për këtë arsye, shumica e njerëzve injorant nuk i vërejnë gjërat e bukura përreth tyre, dhe atë çka vërejnë nuk ka ndonjë kuptim për ta. Përderisa janë të interesuar, atje mund të ketë një perde mbi begatitë e ndryshme të mrekullueshme që i

rrethojnë. Në Kur'an Zoti jonë, përshkruan gjendjen e atyre që kanë sy por nuk shohin:

**A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilat do të dëgjojnë? pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në krahorë. (Haxh 46)**

**Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për Xhehennem. Ata nuk kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët. (Surja Al Araf 179)**

Gjetiu (tjetërkund) Allahu përshkruan kënaqësinë vezulluese në fytyrat e atyre besimtarëve të cilët kënaqen me begatitë e tyre. (Surja **mutaffin**; **24 Ajeti origjinal Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve**).

Në një ajet tjetër Ai shpall:

**104. Juve ju erdhën argumente të qarta nga Zoti i juaj e kush i sheh (kupton) ai e ka për vete, e kush verbërohet, ai e ka për të zezën e vet. E në (pejgamberi) nuk jamë rojë e juaj. (En'nam 104)**

Pra ata që shikojnë në mënyrë të pavëmendshme në bukuritë përreth tyre mund të shohin sikur të ishin mbrapa një perdeje. Natyrisht, njerëzit që jetojnë në mes të disa bukurive natyrore mundohen të shfrytëzojnë përparësitë e saj kurdo që ë është e nevojshme. Për shembull, ata mund të kënaqen duke shkuar në bregdet për t' shikuar perendimin e diellit, ose t' shiqojnë lulet dhe pemët, por kënaqësia e tyre është e kufizuar. Thellë në zemrat e tyre ata nuk kanë kuptim të kënaqësisë. Ata përjetojnë vetëm një kuptim të zakonit dhe shkurtër të kënaqësisë, që së shpejti ia liron



rrugën pandjeshmërisë, mosinteresimit, dhe mërzisë. Brenda një kohe të shkurtë ata dëshirojnë diçka të re, më interesante, dhe më origjinale. Kjo është një shenjë e prishjës dhe pandjeshmërisë së shpirtit të tyre. Ka pabesimtarë të cilët thonë se e dojnë natyrën dhe dëshirojnë të jetojnë në të, disa prej tyre edhe e kanë kaluar një pjesë të gjatë të jetës së tyre duke e bërë këtë. Por, si e masin ata tash kënaqësinë e nxjerrë nga bukuria natyrore?

Besimtarët e dinë se kjo matje varet prej aftësisë së tyre për të ndjerë Fuqinë dhe Madhështinë e Allahut, duke e parë vehtën të vogël (pa vlerë) në krahasim me Krijimin e Tij Madhështor, dhe duke iu nënshtruar Atij me sinçeritet. Vetëm ata të cilët e shohin këtë të vërtetë dhe jetojnë sipas saj Allahu i lejon të shijojnë kënaqësi të vërtetë në këto gjëra të bukura.

Edhe pse jetojnë midis gjithë kësaj bukurie, disa njerëz kurrë nuk mund t'i ikin zbrazësirës në zemrat e tyre, pakënaqësisë dhe dëshpërimit të tyre të brendshëm. Kjo vetëm tregon paaftësinë e tyre për t'u kënaqur me këtë bukuri siç duhet. Përderisa nuk kanë besim në Allahun, bukuria mund t'u jep atyre një kuptim të shkurtë të kënaqësisë dhe të mbaj interesin e tyre vetëm për një kohë të shkurtë. Por një njeri i cili e kupton që të gjitha gjërat e bukura rreth tij i ka krijuar Allahu mund t'a kuptoj më mirë kuptimin mbrapa saj. Ai do t'i kuptoj aspektet më të thella të saj dhe dot përjetoj kënaqësi në çdo zbulim. Si rezultat, ai mund të ndjej kënaqësi të thellë që vjen nga të kuptuarit e Kualiteteve Supreme të Allahut, Madhështinë dhe Mjeshtërinë e Pafund Krijuese, Pushtet dhe Dituri të Pakufishme (infinite), dhe Dominimin mbi të gjitha krijesat. Ky njeri nuk dot kishte nevojë t'i vizitoj të gjitha shtetet për t'parë bukuritë e tyre natyrore. Pasuria dhe thellësia e shpirtit të tij do t'i lejonin atij të kënaqet

me pamjet e vogla të panumërta me të cilat është mësuar ndonëse shkon përpara dhe mbrapa. Kjo prodhon një kuptim të madh të kënaqësisë në brendësi të qeniës së tij. Për shembull, Allahu ka krijuar kafshë si begati (bekim) për qeniet njerëzore. Lloje të panumërta zogjsh rrëshqasin hijshëm nëpër ajr, krahët e tyre të bukur, ngjyrat e tyre të ndezura, dhe puplat e tyre simetrike u japin kënaqësi të gjithë atyre që i shiqojnë me sy të besimit. Mënyra se si një ketër e vogël e bukur i përdor dhëmbët e saj, se si i lëviz putërat, dhe si e lëviz lehtë bishtin, zgjon një kuptim të fortë të dhembshurisë (mëshirës) në zemrën e çdo besimtari. Ky është gjithashtu rasti kur ata shohin një lepur të vogël e tërheqës duke i përdorur putrat e saj për të ngrënë një karrotë, dizajnet në trupin e zebrës, madhësitinë e një kali gallop (lloj kali i shpejtë), bukurinë e një gazele, dhe vetitë e panumërta të të gjitha kafshëve. E nejtja gjë zbatohet edhe për gjelbërimin e ndritshëm të një pylli, madhësitinë e një ujëvare, pamja e majeve (kreshtave) të malit duke çarë retë, dhe lloje të panumërta të drunjëve, luleve, pemëve dhe perimeve. Duke qenë dëshmitarë të këtyre Manifestimeve të Diturisë dhe Mjeshtërisë së Tij Supreme, ata e falemnderojnë Atë. Të gjithë besimtarë kanë një kapacitet të pakufizuar për t'u kënaqur me bukurinë natyrore, një kënaqësi që rritet për shkak të thellimit të shpirtit dhe besimit të tyre. Kjo është një kënaqësi që Allahu u jep vetëm atyre që i afrohen Atij me sinqeritet; Ai ia jep atë vetëm besimtarëve si përgjigje (shpërblim) për aftësinë e tyre që çdo gjë e shohin me sy të besimit. Ata të cilët e mohojnë Allahun e humbin kënaqësinë e këtyre gjërave të mira në këtë botë dhe nuk do t'i kenë ato në botën tjetër. Në botën tjetër, për ta do të ketë vetëm mjerim. Në kur'an Allahu na tërheq vëmendjen në këtë realitet:

**Hiqu atyre që e marrin fenë (në vend që ta resprktojnë) për lojë e dëfrim dhe i ka mashtruar jeta e kësaj bote. Ti përkujto me të (Kur'anin) që të mos bjerë njeriu viktimë e asaj që ka vepruar, e që s'ka mbrojtës as ndërmjetësues për te pos Allahut. Je ai (njeri) edhe nëse jep, çdo lloj shpagimi nuk i pranohet. Të tillët janë ata që ranë viktimë e asaj që punuan. Ata , për skak se mohuan, për pije kanë ujë të vluar e dënim të idhët. (En'nam 70)**

### **Ata nuk janë në gjendje të kënaqen me pastërti**

Pastërtia qet në shesh personalitetin e një individi, karakterin moral, mënyrën e të menduarit dhe inteligjencën. Allahu përmend rëndësinë e saj në Kur'an;

**Dhe rrobat tua pastroji! Dhe të keqës së ndyrë largohu!  
(Mudethirr 4-5)**

Por, pastërtia është një cilësi e cila gjendet vetëm tek ata që kanë besim të singertë. Sikurse cilësitë e tjera të moralit, edhe pastërtia mund t'arrihet vetëm nëpërmes frikës ndaj Allahut. Kjo është për arsye se kushdo që ka frikë nga Allahu e din që, edhe kur është i vetmuar, Allahu e sheh çdo gjë që bënë, dhe në botën tjetër do t'a merr shpërblimin për këtë veper. Ai gjithashtu e din se do të merr kompensim (shpërblim) për çdo gjë që ai ka përkundrazi zërit të ndërgjegjës së tij. -Për këtë arsye, ai iu shmanget çdo veprimi që e inatos (hidhëron) Allahun dhe që në Kur'an është e shpallur si e gabueshme. Në jetën e tij të përditshme, ai praktikon lloje pastërtish që Allahu në Kur'an i përshkruan si formë e adhurimit. Kjo don të thotë kënaqësia e të qenurit në një vend të pastërt, përdorimi i gjërave të pastërta dhe shoqërimi me njerëz të pastërt. Natyrisht, pabesimtarët kanë

mënyrën vet të të kuptuarit të pastërtisë. Disa prej tyre njihen për pastërtinë dhe rregullin e tyre të përpikt, por kjo nuk vjen nga frika dhe respekti i tyre për Allahun ose nga dëshira e tyre për t'a fituar simpatinë e Tij. Prandaj kjo është pastërti që shoqëria prët nga anëtarët e saj. Këta njerëz humbin një marrëveshje të madhe duke mos i udhëhequr jetërat e tyre në pajtim me t'kuptuarit e pastërtisë të shpallur në Kur'an, dhe nga paaftësia e tyre për t'a ndjerë nevojën për të. Si përgjigje ndaj refuzimit të tyre të besimit, Allahu ua ka marrë këtë kënaqësi nga shpirtërat e tyre, dhe i ka detyruar të jetojnë në një mjedis ( rreth) jo të kënaqshëm.

Pabesimtarët janë në dijeni për dy lloje të pastërtisë; e dukshme dhe e padukshme. Ata i japin rëndësinë më të madhe llojit të parë, si pastërtia fizike dhe rroba të pastërta. Megjithatë, pastërtia e jashtme gjithmonë ka një anë që nuk shihet, për pabesimtarët, kur ata janë vetëm ose kur mendojnë se askush nuk i sheh, shpeshherë sillen shumë më ndryshe se kur janë në publik. Është e pamundur të qellohet (dihet) se çka bëjnë ata kur janë vetëm, dhe të tjerë nuk mund t'a dallojnë çka është (dhe çka nuk është) e rëndësishme për ta, sepse kush nuk ka frikë nga Allahu vendos se ç'është e drejt dhe e gabuar në bazë të mendimeve të tij. Shumë njerëz të tillë shiqojnë pastërtinë e tyre fizike dhe të shtëpive të tyre nga jashtë, dhe e masin në bazë të asaj se a vrejnë apo jo ndonjë papastërti. Ata heqin qafe larjën (e vet), larjën e rrobeve, hekurosjes, ndrrimin e qarqafave dhe rizave, dhe rregullimin sepse këto punë të përditshme i mërztin ata. Ata i pastrojnë dhe rregullojnë dollapet e tyre vetëm atëherë kur detyrohen. Disa i përzijnë rrobet e pastërta me ato të papastërta dhe i veshin prap. Përgjithësisht, nëse munden, ata e paguajnë dikend që njëherë në javë të vjen dhe ta kryej pastrimin.

Pavarësisht nga kjo, ata nuk mërzojnë që t'pastrojnë banjot, dyshemetë, dhe pluhurin nëpër qoshe, ose rrëmujën në dhomat e tyre të fjetjes. Shpeshherë disa njerëz janë fizikisht të papastërt. Ata lodhen duke u pastruar, dhe posaçërisht kur moti është i ftohtë, pastrojnë vetëm flokët e tyre. Ata nuk brengosen (nuk ua ndinë) për papastërtinë e tyre fizike, sepse askush nuk mund t'a shoh atë. Gratë i kanë frizerat e tyre që ua "rregullojnë" flokët dhe nuk e ndjejnë të nevojshme t'i pastrojnë derisa t'ju del minivalli (kona). Këta njerëz mundohen t'i fshehin trupat e tyre të papastër duke përdorur parfume (aroma) të rënda dhe deodorant, por kjo edhe më shumë t'largon nga të qenurit tërheqës. Ata mendojnë që t'u vie erë e tymit të duhanit, ushqimit apo djersës është normale. Ata mund të duken gjithmonë nga jashtë të pastërt, dhe rrobat e tyre mund të jenë të hekurosura dhe pa njolla. Por në të vërtetë, ata nuk janë të pastërt, sepse ata strehojnë (fshehin) një kuptim të shtrembëruar të asaj se ç'është pastërtia e vërtetë. Për shembull, ata mund të kenë pak pluhur në rrobat e tyre ose të derdhin diçka në mëngët e tyre, që mund të mos shkaktoj njollë të përhershme, dhe në përgjithësi nuk e konsiderojnë të papastër. Ata mund t'i ndotin ose bëjnë duart e tyre me yndyrë, por pastaj nuk i pastrojnë ato menjëherë. Ata mendojnë se askush nuk po i shoh ata duke e përgatitur ushqimin dhe lehtë mund t'a përdorin garuzhdën (kutllaqën) të cilën nuk e kanë pastruar ose ndonjë kafshatë e cila ka rënë në tavolinën e papastërt të kuzhinës (e cila përdoret për prerje në të) ose edhe në dysheme. Ata mund t'i përdorin enët e palara ose tenxherën e papastërt. Në mënyrë të njëjtë, ata nuk e bezdisin vehtën për pastërtinë e banjove të tyre dhe në këtë mënyrë rrezikojnë jetën e vetë dhe të atyre që jetojnë me ta. Ne mund të themi edhe më tepër se çka mund të bëjnë njerëzit e tillë.

Sikur t'i kishe pyetur ata kishin me thënë se nuk e kanë vërejtur se, rrobat, flokët, duart ose fytyrën i kanë të papastërta. Kjo është sepse e konsiderojnë atë situatë si krejtësisht normale. Edhe nëse i mendojnë (i bëjnë të përhumbur) njerëzit përreth tyre ose bile edhe nëse e rrezikojnë shëndetin e tyre, ata refuzojnë t'a pranojnë të njëjtën. Nuk duhet të harrojmë se ky është një kompenzim që Allahu ia jep një shoqërie injorante. Në njëfarë mënyre, ata që refuzojnë të besojnë marrin shpërblimin për t'keqën që ia kanë bërë kuptimit të shtrembëruar të moralit. Një ide tjetër e gabuar e shtrirë plotësisht është se të mos kushtuarit rëndësi pastërtisë është një aspekt i moralit modern. Njerëzit e tillë mendojnë se kushdo që pengon ndotjen e mjedisit është i dalë nga moda (i prapambetur). Dhe, për arsye se e nxisin njëri-tjetrin të mendojnë kështu, ata ngurrojnë t'a kritikojnë këtë gjë, edhe pse e dinë se një stil i tillë i jetës është i gabuar. Për shembull, ata hyjnë në shtëpitë e tyre me këpucë të ndyta, dhe janë të kënaqur t'i lënë divanet dhe qilimat e tyre të mbuluara me pluhur dhe papastërti. Dhe edhe nëse dikush tjetër hyn në shtëpitë e tyre me këpucë të ndyta dhe ua ndot qilimat, ata nuk e kanë gjalle, të kundështonin do t'ishte e sikletshme. Kjo mënyrë e shtrembëruar e t'menduarit mund të shihet tek njerëzit e rinj. Ata mendojnë se është në rregull të flejnë me të njëjtat rroba që i kanë pasur veshur gjatë tërës ditës. Për ta është normale të hanë një sandviç të yndyr, t'mos i pastrojnë duart e tyre, dhe pastaj t'a fshijnë yndyrën në flokët apo në rrobat e tyre. Nëse rrobat e tyre spërkatën me ujë balte, ata vetëm e fshijnë dhe vazhdojnë rrugën e tyre. Ata besojnë se sa ma e papastërt, me më shumë njolla, dhe sa ma e përdorur të jetë xhaketa e tyre, aq më e lezetshme (cool) është. Farmerkat e tyre bëhen vend (kopsht) për shumim të vërtetë të mikrobeve dhe

bakterieve. Kjo tendencë e njejtë është parë tek ata të cilët i barazojnë intelektualitetin me modernizimin. Ata mendojnë se stili i tyre i jetës dhe mënyra e tyre lecka-lecka e veshjës u jep atyre një pamje të ndryshme dhe superiore. Ti nuk mund t'ju afroresh atyre sepse trupat dhe rrobat e tyre kullojnë nga tymi i duhanit, dhe nuk mund t'i shikosh në sy për shkak të flokëve të tyre të gjatë, të papastërta dhe të çrregullta (helaq) dhe të mjekrrave të pakrehura. Në fakt, ata janë të neveritshëm. Ata mendojnë se po t'ishin të larë dhe të pastërt, dhe po t'a bënin një bisedë në një atmosferë të ndezur, të ajrosur dhe të kënaqshme, ata do t'a humbin aureolën e intelektualitetit të tyre dhe do t'ishin sikur të gjithë të tjerët. Një stil jete i tillë i sëmure ka të dyja efektet; shpirtërore dhe fizike. Meqenëse ata jetojnë në një mjedis të ndyrë, ata shpesh sëmuren; të jetuarit në një vend pa ajër, me puhur dhe të ndyrë ua shkatërron mushkëritë dhe lëkurën e tyre. Nganjëherë ajo bëhet e verdhë (zverdhet). Me kohë, ata humbin aftësinë e tyre për të çmuar bukurinë dhe pamjet e mira, zemrat e tyre ngurtësohen dhe bëhen të paafta të kënaqen me gjëra të mira, dhe shpirtërat e tyre prishen. Për besimtarët, megjithatë, pastërtia është si një veprim i adhurimit ashtu edhe një begati që u jep atyre një kënaqësi të madhe shpirtërore, vetkënaqësi, freskim, rehati, dhe siguri (besim). Prej besimtarëve, besimtarët mund të kenë qetësi mendore, të ulen ku të dojnë, dhe t'përdorin orenditë dhe enët pa ngurrim apo shqetësim (zorr). Ata e dijnë se çdo besimtarë e repekton dhe ka frikë (dronë) nga Allahu, se ata nuk i shkelin parimet morale të Kur'anit, se ata veprojnë në të njejtën mënyrë si në publik ashtu edhe në vetmi, dhe se ata gjithmonë sillen me një dëlirësi të patëmetë në çdo situatë, pikërisht ashtu siq urdhëron Allahu. Ata japin krejt nga

vetja që të sigurohen që ata që janë rreth tyre të gëzojnë nivel të njëjtë të rehatisë, shëndetit, dhe sigurisë të cilat i kanë ata. Ndërgjegjia e tyre i bënë që t'a pranojnë këtë si përgjegjësi dhe të shmangin çdo gjë që mund t'u bënë keq të tjerëve. Ata kënaqen shumë duke formuar mjedise që të ngjajnë në Parajsë.

## **Kënaqësitë e humbura shpirtërore**

### **Dashuria është një bekim i madh të cilën pabesimtarët e hedhin**

Dashuria është një nga emocionet më të forta dhe më të thella që një njeri mund të përjetoj. Gjithashtu është një nga begatitë më të mrekullueshme që Allahu ka krijuar për qeniet njerëzore në këtë botë. Njerëzit kënaqen shumë me dhuratat shpirtërore dhe materiale që Allahu ka krijuar për ta; ata kënaqen me pamje të bukura, shtëpi të rehatshme, muzikë të mirë, dhe gatim të mirë. Por asnjëra nga këto kënaqësi nuk mund të krahasohet me lumturinë që sjell dashuria. Për të përjetuar dashuri të plotë, janë të nevojshme kushte të caktuara. Para së gjithash, një individ duhet të jetë në gjendje të shoh kualitetet e mira të tjerëve dhe të çmoj vetitë e tyre të mira. Sa më e hapur të jetë mendja dhe ndërgjegjja e një individi, aq më e fortë do t'jetë aftësia e tyre për të dashuruar. Por, faktori i vetëm që mund t'ia jep këtë aftësi është besimi dhe frika e tij në Allahun. Prandaj, një njeri është në gjendje të dashuroj n'bazë të masës së besimit dhe frikës së tyre në Allahun; dhe në atë masë ai mund të kënaqet. Në mënyrë të njëjtë, me qëllim që ai t'a don tjetrin, ai njeri duhet t'ketë veti që mund të duhen, dhe prap, këto veti rrjedhin nga frika dhe besimi në Allahun. Sa më shumë një individ t'a don Allahun, dhe sa më



shumë t'i frikësohet Allahut, aq më shumë veti të dashurisë do të ketë ai. Kjo është sepse ai që ka frikë Allahun ka një karakter (veti) të moralit të mirë, dhe s'bashku me frikë ndaj Allahut ata shfaqin mëshirë, tolerancë, siguri, kurajo, vetë-flijim, mençuri dhe ndërgjegje të mirë. Të gjitha këto veti krijojnë në mënyrë të natyrshme një kuptim të fortë dhe të thellë të dashurisë në zemrën e secilit që sheh me sy të besimit. Por nëse mungojnë këto kushte; besimi dhe frika nga Allahu-don të thotë nëse baza e dashurisë mungon - atëherë askush nuk mund të përjetojë dashuri të vërtetë.

Burimi themelor i dashurisë që ndjejnë besimtarët për të tjerët është dashuria e tyre ndaj Allahut. Dijenia se Allahu krijon kënaqësi që vjen prej dashurisë nga zemra që ata ndjejnë për të tjerët, si manifestim të Vetë Atij (Vetvetës së Tij) i jep asaj dashurie thellësinë e saj. Por, pasi që dashuria e pabesimtarëve është e bazuar (themeluar) në pritjen e tyre për dobi (hair), ata realisht kurrë nuk mund të përjetojnë dashuri. Ata i dojnë vetëm ata që janë të dobishëm për ta, që i rehatojnë, dhe që bëjnë atë që ata e konsiderojnë si përkrahje. Por një dashuri e tillë prehet në themelet e shkatërruara dhe asnjëherë nuk mund të bëhet një dashuri e sinqertë dhe e ndjerë nga zemra. Në realitet ata e dojnë vehtën më shumë se të tjerët dhe duke menduar se janë më t'vlefshëm se të tjerët dëshirojnë që të tjerët t'u bëjnë të mira, t'i mbrojnë dhe të interesohen për ta. Sa kohë që e kanë këtë përkujdesje, ata ndjejnë një kuptim të caktuar të dashurisë. Por më së shpeshti kjo lloj dashurie nuk i bënë të tjerët të lumtur ose të ndihen të dashuruar, për këtë është e rremë dhe e drejtuar drejt levërdisë. Duke qenë jo më shumë se një shtirje e sjellshme në kërkim të ndjenjave të njerëzve të tjerë, ajo mbaron kur arrihet qëllimi. Natyrisht, ata nuk mund të tregojnë ndonjë dhëmbshuri

të singertë, pa marr parasysh se sa shpesh e shprehin dashurinë e tyre. Gjithë çka mund të bëjnë është të shqiptojnë disa fjalë dhe fraza stereotipike përgjithësisht në dispozicion për këtë qëllim dhe të përdorura në ditë të caktuara të vëna menjëherë për shprehjet e dashurisë. Megjithatë, besimtarët mund të shprehin dashuri të vërtetë ndaj të tjerëve fjalë të singerta, prekëse, dhe të mrekullueshme, sepse kënaqësia e dashurisë është e gjallë në zemrat e tyre. Me të vërtetë, besimtarë të cilët sinqerisht dashurojnë dhe nderojnë të dashurin asnjëherë nuk dot thonë diçka që e lëndon atë person. Mbi të gjitha, kjo lloj dashurie nuk mvaret nga rrethanat apo ndonjë shpërblimi të pritur nga njerëzit. Dashuria e vërtetë prët shpërblim vetëm prej Allahut, për këtë qëllimi i tij i vetëm është të fitoj simpatinë e Tij. Pabesimtarët mendojnë se dashuria zvogëlohet me kohë për shkak të mërziisë së dyanshme dhe humbjes së entuziazmit. Natyrisht, shumë lidhje në mes të pabesimtarëve përfundojnë në këtë mënyrë, për shkak se dashuria e tyre ka qenë e bazuar në mashtrim dhe asnjëherë nuk ka qenë e vërtetë. Në dashuri të vërtetë, koha gjithmonë luan rol pozitiv, dhe kështu i mundëson çdo njeriu t'ua çmojë më mirë keqardhjen e të tjerëve, mëshirën, bujarinë (zemërgjerësinë), interesimin, vetë-flijimin, dhe vetitë tjera të mira. Me kohë, dashuria e tyre forcohet, sikurse që personalitetet e tyre, kuptimi i moralit, dhe qëndrimet e tyre zhvillohen drejt përsosmërisë. Asnjëherë nuk ka mërzi dhe zhgënjim në dashuri të vërtetë, dhe dukjet e mira, mjetet materiale, dhe prestigji bëhen jorelevante (të pa vend). Gjëja e vetme me rëndësi është karakteri (vetitë) moral i të dashurit/rës. Por pabesimtarët, që gjykojnë çdo gjë në bazë të standardit material, vuajnë atë humbje materiale kur ajo bazë të shembet (shkatërrohet). Mund të shohim se pabesimtarët kanë

një besim të thyer në zemrat e tyre. Për këtë arsye, ata jetojnë në një botë pa dashuri dhe nuk mund të nxjerrin kënaqësi nga gjërat që i japin shpirtit njerëzor kënaqësinë më madhe. Më e rëndësishmja është se, këta njerëz nuk mund t'a dijnë dashurinë e vertetë dhe si të dashurojnë dhe t'jenë të dashur nga të tjerët, ata nuk do t'a përjetojnë këtë begati në Parajsë, i cili është një vend i mbushur me dashuri të Allahut. Atje, njerëzit dot dinë si të dashurojnë dhe si të përjetojnë kënaqësinë e të qenit të dashur. Në Kur'an Allahu n'a tegon për bekimet që i presin besimtarët në Parajsë si shpërblim për karakterin e moralit të mirë të tyre. Njëra nga këto do të jetë dashuria e zjarrtë që ndajnë dy partner. Në ajetet vijuese, Allahu përshkruan se si duket Parajsa;

**Janë në shtretër të qendisur me ar. Të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit. Atyre u shërbejnë djelmossa të gjithmonshëm. Me gastare, me ibrigë dhe me gota të mbushura plot prej burimit. Prej së cilës pije (vere) as nuk i dhemb koka, as nuk dehen. Edhe pemë sipas dëshirës së tyre. Edhe mish shpezësh, cilin ta duan. Dhe (gratë e tyre janë) hyri symëdha. Si të ishim inxhi të ruajtura. Shpërblim për atë, që ata punuan. Aty nuk dëgjojnë fjalë të këqija as që janë mëkat (gënjeshtrë). Vetëm thënie: selam pas selami. E për sa u përket atyre të djathtëve, çka është gjendja e të djathtëve? Janë nën drunj të pemëve pa therra (pa gjemba). Të bananeve me fruta palë-palë. Nën hije të përhershme. Pranë ujit rrjedhës. Edhe ndër pemë shumë llojesh. Që as nuk ndërprehen, as nuk janë të ndaluara. Edhe shtretër të lartë (ose gra të larta). Ne i kemi krijuar ato në një krijim të ri (formë të re). Dhe ato i kemi bërë virgjëresha. Të dashuruara (për burrat e vet), të një moshe. (Ato janë) për ata të djathtët. (Surja Al Wakia 15-38)**

## **Humbja e besnikërisë dhe besueshmërisë**

Siç kemi thënë që në fillim të këtij libri, injorantët i bazojnë sjelljet e tyre në marrjën e çdo gjëje që munden nga jeta e tyre dhe njerëzit e tjerë përreth. Ky qëllim bosh i drejton ata që t'vlerësojnë çdo gjë nga pikëpamja e fitimit dhe deri te ky qëllim ata janë t'përgatitur të flijojnë gati çdo gjë, duke përfshirë shumë prej gjërave që ata i çmojnë më së shumti dhe të gjithë ata për t'cilët deklarojnë se i dojnë. Prandaj, është e pamundur që këta njerëz të përjetojnë besnikëri dhe besueshmëri të vërtetë. Në kërkimin e tyre të zjarrtë për para, mallra, dhe prona pabesimtarët harrojnë rëndësinë e ndjenjës së dashurisë, respektit, dhe besnikërisë. Ata, gabimisht (pa vend) mendojnë se gjërat materiale do t'i bëjnë më të lumtur.

Megjithatë, siç thamë edhe më herët, asnjëra prej këtyre gjërave nuk do t'u sjell kënaqësinë që e kërkojnë. Pa marrë parasysh se sa kanë respekt, famë dhe nam në shoqëri dhe pa marrë parasysh se sa kanë mallra dhe pronë asnjëra nga këto gjëra nuk mund tu blejë atyre shoqëri të vërtetë njerëzore dhe besnikëri. Të lënë pa këto vlera ata kurrë me të vërtetë nuk mund të bëhen shokë me dikënd, sepse ata gjithmonë e pyesin vehtën se n'cilat baza dhe sipas çfarë kritereve ata duhet t'i zgjedhin shokët. Në vend se të kërkojnë shokë që respektojnë dhe kanë frikë Allahun dhe përcjellin parimet morale të Kur'anit, ata kërkojnë njerëz prej t'cilëve kanë përfitim dhe t'cilët i bëjnë ata t'jenë të respektuar nga kolegët e tyre. Njerëzit që jetojnë në një pjesë të mirë të qytetit duhet t'zgjedhin shokët të cilët jetojnë në një zonë të ngjajshme. Ata duhet të jenë të pasur, tërheqës dhe të pashëm, t'kenë një veturë të re, të vijnë nga një familje e mirë, apo të kenë një emër të respektuar. Për ata që jetojnë në një lagje më modeste,

një shok i ardhshëm duhet së paku të jetë e respektuar atje: ai apo ajo duhet të jetë e diplomuar në një shkollë të mirë, t'ketë profesion të respektuar, të jetë mjaft tërheqëse dhe e pashme, dhe mjaft e fortë për t' siguruar trajtim të sjellshëm. Por asnjëra nga këto cilësi nuk lejon një rritje të dyanshme të besnikërisë dhe besueshmërisë. Në një shoqëri të tillë, përgojimi, tradhëtia, dhe flijimi i një shoku për levërdi janë mjaft të zakonshme. Në mënyrë të njejtë, nëse dikush prej shokëve futet në probleme materiale dhe psikologjike dhe ka nevojë për ndihmë, kjo mund t'i jap fund shoqërisë, duke e ditur që të tjerët mund t' mos jenë të gatshëm t'ia shtrijnë dorën sepse nuk kanë levërdi t'a bëjnë një gjë të tillë. Kështu, zgjidhja më e mirë është t'a braktisin shokun e tyre dhe të kërkojnë dikend për t'a plotësuar boshllëkun dhe i cili do të jetë i dobishëm për ta. Ne mund t'a shohim këtë pabesi ndër pabesimtarë të martuar.

Me të vërtetë shpesh ata flasin në lidhje me këtë se si janë trajtuar padrejtësisht. Ka aq shumë pabesi midis bashkëshortëve sa që nuk duket më e çuditshme. Kur të martohen, çftet premtojnë se do t' jenë besnik ndaj njëri-tjetrit në kohëra ë mira dhe të këqija, se nuk do t'a braktisin njëri-tjetrin, dhe se do të kujdesen dhe mbrojnë njëri-tjetrin. Por së shpejti, këto premtime thehen, dhe duhet të gjenden mënyra tjera për t' siguruar besnikëri. Disa e bëjnë nëpërmes kontratave prenuptiale (lloj kontrate që bëhet midis bashkëshortëve para martese ku shkruhet se si dot ndahet pasuria nmes tyre në rast se ndahen) për t'a mbrojtur pronën e tyre. Për t'i shmangur rreziqet e mundshme materiale dhe emocionale, ata nënshkruajnë kontrata se kush- çka do të merr në rast se vendosin të ndahen. Kjo e sqaron se si e kosniderojnë njëri-tjetrin këto do palë. Qartë, dashuria e tyre, respekti dhe

shoqëria nuk është e bazuar në besnikëri dhe besueshmëri, dhe kështu qysh nga fillimi e pranojnë mundësinë se nuk do t' mbesin gjithmonë burrë e grua. Një marrëdhënie e tillë e luhatshme është gjithmonë në rrezik të merr fund. Shembuj të pabesisë shpesh shihen në jetërat e tyre profesionale. Për të bërë më shumë para, shpesh ata mund t' mashtrojnë njëri-tjetrin ose edhe të vjedhin para nga të tjerët. Shumë pabesimtarë ankohen se marrëdhëniet me shokët e tyre janë prishur për këtë arsye dhe kështu nuk kanë dëshirë të bëjnë biznes me të afërmit e tyre. Kjo pabesi mund të shihet në shoqëri në tërësi. Shpesh, shoqëria i trajton disa njerëz me respekt dhe vlerësim, dhe ata marrin lavdëratat dhe lajkatime nga njerëzit. Por kur ata humbin dobishmërinë, ata gjithashtu humbin këtë respekt dhe dashuri. Shembuj të këtij lloji të pabesisë mund të shihen gati gjithëkund. Jetimoret, shtëpiat e pleqve, dhe qendrat për trajtimin e njerëzve të dhënë pas drogës, janë vende ku kjo pabesi reflekton në mënyrën më të qartë. Kur njerëzit që dikur kanë qenë të dobishëm për tjerët dhe të dashur dhe respektuar humbin çkado që i ka bërë objekte të vëmendjes, ata braktisen dhe lihen vetëm edhe nga fëmijët, nipat dhe të afërmit e tyre. Prindërit mund të shpenzojnë vite dhe shumë mund për t' i rritur fëmijët e tyre, por për shkak se nuk pasojnë parimet morale të Kur'anit, fëmijët mund t' i lënë ata vetëm në pleqëri. Me kohë, shoqëria i harron ata që i kanë shërbyer mirë asaj në fushat e politikës, kulturës ose edukimit. Gjatë viteve shkollore, familja dhe studentët tregojnë respekt të madh për mësuesit e tyre, i dëgjojnë ata dhe mundohen t' i bëjnë ata për vete. Por sapo të mbaroj shkolla, studentët i harrojnë mësuesit e tyre sepse dobia (vlera) e tyre ka mbaruar. Një çështje për t' a mbajtur në mend këtu është se pabesia dhe jobesnikëria të hasur nga pabesimtarët

në fakt është një reflektim i karakterit të “moralit” të tyre. Duke drejtuar jetërat e tyre sipas direktivave dhe sistemeve të tyre t’moralit, ata marrin shpërblimin e të mos qenit të lidhur me dikend me ndonjë besnikëri dhe besueshmëri të vërtetë. Megjithëate, shoqëria e formuar nga besimtarët të cilët pasojnë parimet morale të Kur’anit nuk e ka asnjërën nga këto shqetësime. Besimtarët e duan njëri-tjetrin pa shiquar levërdinë, rininë apo shëndetin. Matja e vetme që ata i bëjnë dashurisë së tyre është dashuria e të tjerëve për Allahut dhe karakteri i tyre i moralit të mirë. Nëse këto janë në vend, nuk ka rëndësi për një person se a plaket, bëhet nevojtari, ose i paaftë për t’fituar para. Besimtarët do të vazhdojnë t’a trajtojnë me dashuri dhe respekt të sinqertë. N’fakt, besnikëria dhe besueshmëria e vërtetë vijnë vetëm duke zbatuar mësimet morale të Kur’anit. Ata që e dojnë njëri-tjetrin, nga dashuria e tyre ndaj Allahut ata janë të palëkundur në shoqërinë e tyre dhe në shfaqjen e dashurisë dhe respektit. Vetëm ata mund t’a kuptojnë kënaqësinë që vjen nga një kuptim i besnikërisë dhe besueshmërisë.

### **Humbja e admirimit dhe respektit për të tjerët**

Respekti tregon dashurinë e njerëzve ndaj njëri-tjetrit dhe vlerën e vendosur mbi to. Cilësitë e mira që shihen tek të tjerët tërheqin një kuptim të thellë të respektit ndaj të tjerëve. Por, një karakter i mirë mund të vie vetëm duke pasuar parimet morale të Kur’anit, dhe një karakter të pjekur, të besueshëm, dhe stabil të moralit që mund të mbahet (ruhet) në të gjitha situatat mund të arrihet vetëm duke pasur frikë nga Allahu. Natyrisht, shoqëritë injorante kanë një koncept të caktuar të respektit, por të kuptuarit e tyre është e bazuar në themele të rreme. Ata të cilët jetojnë sipas

kritereve injorante tregojnë dashuri dhe përkrahje për ata për t'cilët mendojnë se janë epror të tyre. Nëse një person tjetër është më i pasur, më i respektuar, flitet më tepër për të, më i vënë re dhe ka një karrierë më të lakmueshme kjo është një bazë për respekt e një shoqërie injorante. Ndaj një kuptueshmërie të tillë, karakteri moral i një personi, qoftë se i kryen apo jo punët mirë dhe qëndrimi i tij ndaj të tjerëve përreth tij shihen si të parëndësishme. Edhe nëse kanë siguruar pasurinë dhe namin e tyre prej burimeve të pasigurta dhe të paligjshme, ata trajtohen me respekt dhe admirim nga disa segmente të shoqërisë. Por kjo nuk është admirim apo respekt i vërtetë, për këtë bazohet në atë se si të tjerët mendojnë se mund të përfitojnë prej tyre. Që nga fillimi i këtij libri, ne kemi përmendur se për shkak se këta njerëz refuzojnë Allahun, ata nuk mund t'a çmojnë karakterin e moralit të mirë të të tjerëve siç duhet, intelektin e përpunuar ose cilësi tjera të admirueshme. Për këtë arsye të njejtë, ata nuk mund të ndiejnë ndonjë kënaqësi apo admirim natyror në zemrat e tyre. Përkundrazi, kjo i zemëron ata edhe nëse për hir të levërdisë, ata duhet të shtirren se respektojnë dikend që nuk e dojnë. Në fakt, njerëzit që nuk i praktikojnë parimet morale të fesë gjithmonë dëshirojnë që ata të jenë superior, të respektuar dhe të admiruar. Ata kanë dëshirë t'a thonë fjalën e fundit dhe të tjerët të bëjnë si u thonë këta. Dhe e lëndon krenarinë e tyre nëse duhet të bëjnë kompromis unin e tyre, qoftë edhe përkohësisht, për hir të dikujt tjetër. Gjëja interesante këtu është se në mbarim të marrjës së respektit të rremë personi është në dijeni mbi situatën. Ai e din se tjetri nuk e respekton me të vërtetë, por e përdor fuqinë materiale që ka, duke u shtirur se nuk e vërenë ate duke përdorur respekt të rremë në avantazh të tij.



Në anën tjetër, besimtarët, të cilët nuk sundohen nga josinqeriteti, e dojnë njëri-tjetrin sinqerisht për shkak të cilësive të mira të moralit që shohin në njëri-tjetrin. Prandaj, respekti i tyre është i pandryshueshëm. Kur'ani u thotë bjesimtarëve t'a respektojnë njëri-tjetrin, dhe kështu japin krejt nga vetja për të praktikuar këto parime të larta të moralit me qëllim që t'fitojnë simpatinë e Tij. Ata veprojnë duke ditur se respekti i rremë është i papranueshëm në shikimin e Allahut dhe se Ai do t'u kompenzoj për atë që kanë në zemrat e tyre. Rrallë gjindet një respekt dhe admirim i tillë tek pabesimtarët. Disa individ mund të jenë mosrespektues ndaj prindërve të tyre, të cilët i kanë rritur me vështirësi. Të tjerët mund të tregojnë mosrespekt të madh ndaj njerëzve më të vjetër që shohin në rrugë duke i munduar (hipur në qafë), apo duke u tallur me dobësitë e shkaktuara nga moshja dhe shëndeti i keq i tyre. Megjithatë, Allahu i këshillon besimtarët të jenë të mëshirshëm, dhurues, të respektueshëm ndaj të pastrehëve, të varfërve, të burgosurve, prindërve dhe jetimave. Dhe kështu besimtarët e sinqertë japin gjithçka nga vetja për t'i respektuar më të vjetrit dhe të jenë të durueshëm kur prindërit e tyre të bëhen nevojtar dhe të dobësuar nga moshja. Në Kur'an Allahu shpall këto urdhëra për besimtarët:

**Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). (Isra 23)**

**Adhurone All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, sillnu mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të**

**varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet. (Nisa 36)**

### **Ata kur nuk mund t'i dinë kënaqësitë e miqësisë**

Gjithkush, gjithmonë kërkon një shok të mirë, dikush me të cilin do t'a ndajnë lumturinë, i cili do t'i përkrah në kohë të vështira, dhe që u ndihmojnë të gjejnë përgjigje në probleme të vështira. Gjithkush dëshironë t'a gjen dikend i cili do t'i ofroj dashuri pa kushte, besnikëri, interesim, mirëkuptim, dhe rehati gjatë kohës së sëmundjes dhe pleqërisë. Por pasi që njerëzit e tillë është vështirë të gjenden, shumica e njerëzve janë të kënaqur t'a gjejnë vetëm një shok të mirë.

Natyrisht, gjetja e një shoku (miku) të vërtetë është një bekim i vërtetë. Shokët e tillë qëndrojnë me ty në kohë të mira dhe në të këqija, dëshirojnë për ty atë që dëshirojnë për vetën, dëshirojnë që ti t'jesh i lumtur dhe t'kesh më të mirën ashtu siq i kishin dashur ato gjëra për vetën. Me fjalë të tjera, shokët e tillë asjëherë nuk janë xheloz me njëri-tjetrin. Prej cilësive të tyre është dëshira që shokët e tyre të jenë të lumtur në të dy botërat. Prej cilësive të tyre është se ata janë të hapur dhe të sinqertë me njëri-tjetrin rreth gabimeve (t'metave) të tyre dhe u tregojnë atyre se si t'i kapërcejnë ato. Përgjithësisht njerëzit mendojnë se ky është një qëndrim agresiv, megjithatë, vetëm një shok i vërtetë do t'a bënte këtë. Ata të cilët kanë një ndjenjë të konkurrencës dhe zilisë (lakmisë) për tjetrin nuk do të tregojnë gabimet e njerëzve të tjerë nëse nuk janë të detyruar, për arsye se nuk dëshirojnë që personi tjetër të jetë më i mirë se ata. Dhe kështu i lavdërojnë ata; "Ti je

shumë i mirë”, “Mos ndrysho”, “Gjithmonë qëndro ashtu si je”. Për të qenë një shok i mirë, ti duhet të jesh në gjendje t’i duash shokët e tu për shkak të cilësive të tyre të mira; frika dhe respekti i tyre ndaj Allahut, sinqeriteti, dhe karakteri i moralit të mirë. Vetëm shoqëria e themeluar mbi këto vlera është e qëndrueshme. Kështu, edhe pse dëshira e tyre për t’a bërë këtë mund të jetë e madhe, ata të karakterit të moralit injorant shumë shpesh nuk mund t’a gjejnë asnjë shok të mirë. Pa dyshim ju keni ndëgjuar njerëzit duke bërë ankesa të ngjajshme me këto, “Jam shumë i vetmuar”, “Nuk kam asnjë shok të vetëm” dhe “të gjithë kanë shkuar dhe më kanë lënë në baltë”. Unë mendoj se ata kanë qenë shokë që të lënë në baltë. Miqësitë e bazuara në pasuri, bukuri, respekt, pozitë apo statusin social asnjëherë nuk zgjasin shumë për shkak se ndryshojnë kushtet. Posa të ndryshojnë disa kushtet në të cilat bazohet miqësia, miqësia mbaron vetvetiu. Për shembull, pabesimtarët mund të shoqërohen me dikend që është tërheqës dhe i/e pashme. Por në qoftë se pamjet e këtij personi ndryshojnë për shkak të një aksidenti dhe nevojës për t’u përkujdesur për të, atëherë miqësia mbaron. Megjithatë, nëse miqësia e tyre ka qenë e bazuar në frikën reciproke dhe respektin ndaj Allahut, besimin, dhe parimet e larta të moralit, çfarëdo ndryshimi fizik nuk do t’mund t’a ndryshonte këtë. Përkundrazi, një shok i vërtetë do të ndiente edhe më shumë keqardhje. Edhe vetë pabesimtarët vuajnë nga kjo pabesi. Për shembull, ata mund t’i humbin dukjet e tyre, rininë, pasurinë dhe mallrat dhe së shpejti e gjejnë vehtën të braktisur nga ata për të cilët kanë menduar se ishin shokë të vërtetë. Në kohëra të mira, këta njerëz ishin të afërt dhe të ngushtë dhe kanë premtuar se do të jenë besnik deri në vdekje, por tani, ata shtirren se nuk e njohin njëri-

tjetrin. Ata nuk kanë me kend t'i ndajnë problemet, askend që mund t'i besojnë, të kërkojnë këshillë dhe ndihmë. Ata zbulojnë se shokët i kanë dashur ata vetëm për përfitimet që kanë mundur t'u ofrojnë. Megjithatë, besimtarët jetojnë në një mjedis të përshkuar nga frika në Allahun dhe besimi, dhe e gjithë kjo krijon ndjenjat e dashurisë dhe respektit. Ata të cilët nuk pasojnë parimet morale të Kur'anit dhe i dinë parimet e turpshme të moralit të njëri-tjetrit nuk mund të besojnë apo të ndjejnë dashuri të vërtetë dhe respekt për të tjerët. Si mund t'a duash dikend për t'cilin e di se është gënjeshtar dhe një dyfityrësh dhe i shfrytëzon të tjerët për përfitime të veta? Edhe nëse i trajtoni ata si shokë të afërt dhe të ngushtë, ti e din se miqësia e tyre është e pasinqertë sepse ata kanë një motiv të mëvonshëm në mendje. Ky stil i jetës, produkt i mosbesimit është një mbarim i vërtetë e i vdekur. Ata e dinë këtë dhe gjithmonë ankohen për kënaqësitë që i kanë humbur, dhe ende nuk e kërkojnë lumturinë në besim duke ndjekur parimet morale të Kur'anit. Ata kurrë nuk do t'i zgjidhin vështërsitë tyre, sepse kërkojnë zgjidhje të bazuara në mosbesim.

### **Ata nuk mund t'i shijojnë kënaqësitë që vijnë duke qenë të sinqertë**

Njerëzit e sinqertë janë gjithmonë të njejtë, pa marr parasysh se a i shohin të tjerët ata a jo, dhe për këtë çka ndijnë dhe përjetojnë ata nga brenda reflekton edhe jashtë. Ata janë të ndershëm, të hapur dhe të drejtpërdrejt (të çiltër), nuk i fshehin mendimet dhe ndjenjat e tyre të vërteta, e tregojnë karakterin e tyre pa llogaritur, dhe e prezentojnë vehtën ashtu si janë në ralitet. Sinqeriteti e ngrit besimin dhe i lidh njerëzit në dashuri dhe respekt. Allahu i ka krijuar qeniet njerëzore në atë mënyrë që nëse

i praktikojnë parimet morale të Kur'anit, ata do të jetojnë duke qenë të kënaqur, të lumtur dhe të lehtësuar. Kështu, ata që nuk janë të sinqertë e humbin respektin e të tjerëve dhe si rezultat, nuk mund t'i dojnë dhe respektojnë shokët e tyre të supozuar dhe kolegët e ngushtë. Duke jetuar një jetë publike e cila është e kundërt nga jeta e tyre private, dhe duke e bazuar jetën e tyre publike në mashtrim, pandershmëri, dhe në shtirje, sjell shqetësim dhe falsitet edhe ndaj atyre që i kanë konsideruar si shokë të ngushtë.

Pabesimtarët jetojnë këtë jetë të ngopur me shqetësim, si një i larguar nga rrethi i ngushtë (familiariteti). Duke mos pasur në zemrat e tyre përvojë dashurie, respekti dhe mëshire ata vetëm mund t'i imitojnë këto ndjenja. Shtirja e tyre është e qartë, megjithëate, se çka njerëzit ndijnë në zemra medoemos reflekton në qëndrimet e tyre. Dashuria e sinqertë nuk mund të fshihet, kështu që është e qartë në fytyrën e njeriut, pamjen e jashtme, sjelljen, dhe qëndrimin. Në të njejtën mënyrë, zemërimi dhe antipatia e brendshme i njerit, reflekton në shprehjen e tij të fytyrës, zgjedhjet e fjalëve dhe të fjalive. Me këtë lloj sjelljeje injorantën veçse dëmtojnë vetvetën. Ata u afrohen të tjerëve me josinqeritet, me pretendime të rreme, dhe atyre që u drejtohen, u drejtojnë të njejtin josinqeritet edhe atyre. Gjatë gjithë jetës së tyre, siq thamë edhemë herët, ata janë djegur për një shok të sinqertë dhe të ndershëm, por asnjëherë nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë një begati të tillë- për shkak të të kuptuarit të shtrembëruar të moralit, që dominon në shoqërinë e tyre. Nuk mund të jenë shokë të sinqertë me askend, dhe nuk mund të përjetojnë asnjë marrëdhënie të afërt dhe të ngrohtë. Ata do të lidhen me shokët e tyre më të ngushtë, prindërit apo

bashkëshortet me të njejtin josinqeritet. Megjithatë, të qenurit i ndershëm, i sinqertë, dhe duke pasur një shpirt transparent dhe të sinqertë u sjell kënaqësi të madhe, për shkak se qeniet njerëzore janë krijuar që t'jetojnë në këtë mënyrë. Për këtë arsye, ata që sillen në bazë të natyrë së lindur të tyre nxjerrin kënaqësi të madhe nga qetësia e ndërgjegjës së tyre. Edhe nëse e dinë se do të vuajnë ndonjë pengesë, kënaqësia e nxjerrë nga ndërgjegjja e qetë e tyre, asnjëherë nuk do të lëkundet. Por pabesimtarët të cilët nuk bëjnë asnjë përpjekje që t'jenë të sinqertë janë të zhytur në cilësitë e moralit negativ të tyre, duke u frikësuar se të tjerët dot mësojnë për cilësitë e vërteta të tyre. Prandaj, ata i fshehin mendimet dhe ndjenjat e tyre të vërteta aq sa munden. Besimtarët në anën tjetër, nuk ngurrojnë t'i shfaqin kualitetet (cilësitë) që i kanë në zemrat e tyre. Nëse mendojnë mirë për dikend, ata ia tregojnë atij personi haptazi, nëse mendojnë negativisht për diçka, ata ia thonë këtë në një mënyrë që do t'ishte e dobishme për personin tjetër, për këtë edhe Allahu u thot njerëzve t'i thirrën njerëzit në të mirë dhe t'mundohen t'i largojnë (zhbindin) nga e keqja:

**(Të Xhennetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falenderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe përmbushin dispozitat e All-llahut. Pra, përgëzoj besimtarët. (Tewbe 112)**

Pabesimtarët besojnë se do të vuajnë nëse shfaqin ndonjë kuptim të ndershmërisë. Megjithatë, ky është një burim i rëndësishëm i dashurisë për njerëzit të cilët jetojnë me të njejtin nderë dhe sinqeritet. Asnjë kompliment apo përkujdesje nuk mund të krijojë dashuri, afërsi dhe besën të cilën sinqeriteti e vendos në

zemrat e tyre. Kështu, ata i hargojnë të gjitha kënaqësitë që këto cilësi të mira i japin shpirtit, kështu që idetë e tyre të shtrembëruara i bëjnë ata që pretendimi i rremë dhe dredhia t'u duken më tërheqëse. Prapë, janë vetë ata që vuajnë më së shumti nga ajo që besojnë, dhe edhe pse gjatë tërës jetës së tyre janë të mashtruar nga ata përreth tyre, ata nuk heqin dorë nga idetë e tyre. Në Kur'an, Allahu na tregon se ata të cilët e mohojnë Atë, e kuptojnë se nuk ka zgjidhje tjetër përpos parimeve morale të fesë. Por, mohuesit janë të përcaktuar të jetojnë në sistemet e tyre të shtrembëruara, dhe ata vuajnë si shpërblim për këtë:

**Që i dëgjon ajetet e All-llahut, të cilat lexohen, e pastaj vazhdo prapë si mendjemadh sikur nuk i ka dëgjuar ato. Atë lajmroje për një vuajtje të dhembshme. (Xhathia 8)**

**Dhe ata ishin vazhdimisht në mëkatin e madh. (Vakia 46)**

### **Ata i kanë humbur kënaqësitë e sjelljes me moral**

Secili ka dëshirë të shoh qëndrimet e moralit të pjekur që janë në pajtim me ato të mësuar nga Kur'ani, që të trajtohen mirë, që të tolerohen dështimet e tyre, të trajtohen me drejtësi nëse rrjedh problemi, dhe t'u afrohem me një ngrohtësi të plotë nderim, pavarësisht nga niveli i arrogancës së tyre. Pa marrë parasysh se sa e papranueshme të jetë sjellja e tyre, ata dëshirojnë që të tjerët të jenë të durueshëm me ta, t'u ofrojnë ndihmë kur kanë nevojë për të, t'u falin gabimet pavarësisht nga natyra e tyre e vazhdueshme, dhe t'i trajtojnë me respekt. Kur kjo t' mos ndodh, ata pezmatohen dhe asnjëherë nuk ndalen së ankuari se njerëzimi është i vdekur, njerëzit nuk janë siç kanë qenë më parë, të gjithë mendojnë vetëm për vehtën e tyre, dhe se njerëzit nuk mund të ndjejnë më me emocionet e njerëzimit në këtë botë materiale.

Pavarësisht nga këto akuza, ata nuk bëjnë asnjë përpjekje t'i trajtojnë të tjerët në ndonjë mënyrë më të mirë. Ata dëshirojnë që të tjerët t'i trajtojnë me mirësi, përderisa ata mendojnë vetëm për vehtën e tyre. Ata dëshirojnë më tepër që vuajtjet të bijnë mbi të tjerët se sa mbi ta, dhe për shkak të besimeve të tyre injorante, ata shmangin sjelljen me moral. Në rrënjë të kësaj logjike të prapambetur qëndron mungesa e frikës nga Allahu: si rezultat, këta njerëz veprojnë më tepër vetëm sa për hir të përfitimit, se sa që ia vëjnë veshin zërit të ndërgjegjës së tyre. Vetëm besimi dhe respekti dhe frika e njeriut ndaj Allahut mund të shkaktoj një karakter të moralit të mirë. Përndryshe, sjellja e mirë e njeriut është gjithmonë e llogaritur dhe e herë pas hershme. Për shembull, kur ai ndjen se mund të përfitoj nga ndonjë shitblerje, ai mund të duket se i vë menjanë parimet e tij të moralit injorant: papritmas ai mund të duket si bujar dhe tolerant, por është i drejtuar kah një sjellje e dukshme e moralit nga përfitimet që ai pret t'i ketë. Kjo mënyrë e shtrembëruar e t'menduarit është shumë e dëmshme. Pa marrë parasysh se sa i nënvlerësojnë këta njerëz fitimet e kësaj bote dhe të heqin dorë nga sjellja egoiste, jotolerante dhe e padrejtë, sjellja e pahijshme e moralit të tyre i shkakton shpirtit të tyre një dëm të madh. Çdoherë që bëjnë diçka kundër ndërgjegjës së tyre, ata bëhen më të hutuar dhe më të zbrazët përbrenda, dhe më të humbur shpirtërisht. Për çdo ditë ata kanë mundësi të veprojnë në një mënyrë pozitive, por gjithmonë ata i keqpërdorin këto mundësi. Ndërgjegjet e tyre bëhen të pandjeshme. Asgjë nuk i lëviz, dhe ata mund të kryejnë edhe veprimin më të keq pa brejtjen më të vockël të ndërgjegjës. Ata kanë dëshirë të kalojnë një jetë të mirë në një botë të mrekullueshme pa punuar për të.



**Njeriu nuk lodhet prej kërkesës për mirë, e kur atë e godit e keqja, ai keqësohet shumë dhe humb shpresën. (Fussilet 49)**

Por pa punë, asgjë e mirë nuk mund të prodhohet. Kur vjen pyetja e punës drejt një karakteri të moralit të mirë, ata thonë: “Kështu jam unë” ose “Nuk mund të ndryshoj në këtë moshë”. Por, personaliteti i këtij individi nuk është punë e moshës së tij apo mënyrës se si është rritur ai. Ai thjesht ka dëshirë të veproj ashtu si të don pa bërë asnjë përpjekje. Një person mund ta arrij një karakter të mirë vetëm atëherë kur punon për të dhe kur këmbëngul të bëjë gjëra të drejta. Por, individët injorant nuk shohin arsye t’ a trajnojnë unën e tyre apo ti përdorin dëshirat e tyre. Ata nuk besojnë në jetën e përtejme ose se në Ditën e Gjykimit ata do të thirren për t’ dhënë llogari se a kanë vepruar në bazë të ndërgjegjës së tyre. Kështu ata nuk mund të shohin arsye pse t’ i nënshtrohen një pune të tillë të rëndë ose pse prapëseprapë nuk duhet të sillen si të dëshirojnë. Megjithatë, ata janë gabim dhe do të japin llogari për gjithçka që kanë bërë tek nuk konsultoheshin me ndërgjegjën e tyre. Veç kësaj, një karakter i moralit të mirë, u lejon njerëzve të kënaqen në këtë jetë, për shkak se prodhon gëzim dhe kënaqësi në shpirtin e njeriut gjë që në intensitet nuk mund të krahasohet me asnjë përfitim material. Askush nuk mund t’ a kuptoj këtë në mungesë të përvojës së drejtëpërdrejtë. Kjo kënaqësi është e kundërta e saktë zbrazëtisë e prodhuar në shpirtin e njeriut nga mosbesimi. Pasi që gëzimi dhe kënaqësia që vijnë nga ndëgjimi i ndërgjegjës së njeriut nuk mund të gjenden në lakminë e përfitimeve të kësaj bote, karakteri egoist i pabesimtarëve bënë që ata të jetojnë në një botë të errët, një që nuk ka hapësirë për njerëz bujar dhe tolerant, t’butë dhe falës, dhe të mëshirshëm dhe të dashur. Prandaj, ata janë të denuar

të jetojnë në një botë të kaosit dhe rrëmujës, një botë që nuk ofron paqe, miqësi apo qetësi. Të paaftë të gjejnë qetësi në të qenurit bujar, ata jetojnë me brejtje të ndërgjegjës që sjell egoizmi. Pasi që kurrë ata nuk kanë ditur të jenë të ndjeshëm dhe të flasin butësisht, ata vuajnë nga të jetuarit në një rreth kundërshtues dhe grindavec. Ata e dinë mjerimin fizik dhe shpirtëror të irritimit, dhe iu përgjigjen asaj duke bërë titur dhe duke e kthyer në dhunë fizike. Ata jetojnë në një mjedis të vështirë, në një mjedis ku njerëzit flasin me inat dhe sarkazëm dhe dëshirojnë t'a kënaqin dëshirën e tyre për hakmarrje. Të paaftë që në mënyrë të lehtë të shfaqin përrulje, ata forcohen me krenari dhe arrogancën e tyre të trishtuar. Gjithmonë dëshirojnë më shumë, nuk dinë asgjë rreth qetësisë shpirtërore që vjen nga të qenurit i falemnderuar dhe i kënaqur, dhe duhet t'i durojnë vështërsitë duke qenë lakmitar dhe koprrac (dorështrënguar). Ata janë në ankth të vazhdueshëm sepse ata veprojnë në kundërshtim me ndërgjegjën e tyre. Dhe fakti që njerëzit përreth tyre gjithmonë shfaqin të njëjtin karakter të moralit, i dëshpëron dhe i irriton ata. Natyrisht, ata që kanë për qëllim të jetojnë jetëra të mira dhe sa më shumë shfrytëzojnë dhuratën e kësaj bote janë të dëshpëruar nga këto jetëra të zhytura në errësirë. Por kurrë mos e harroni, që këta individë me vetëdashje i kanë zgjedhur këto jetëra të errësirës. Ndonëse për ta është e mundshme t'a besojnë Allahun dhe t'i shijojnë kënaqësitë e bollshme të të dy botërave, ata janë të kënaqur me ca kënaqësi t'përkohshme e materiale të kësaj bote. Ndonëse mund të jetojnë një jetë me moral të mirë duke zgjedhur të ndjekin ndërgjegjën e tyre në vend të dëshirave të tyre egoiste, ata zgjedhin këte të fundit. Në dëshirën e tyre për një mjedis kaotik, ata me dashje i shkatërrojnë kënaqësitë që mund t'i kishin pasur.

Allahu na informon se çka i prët njerëzit e tillë në botën e pëртеjme:

**Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dynjasë dhe kanë gjetur prehje në të, dhe ata që janë indierentë ndaj argumenteve Tona. Vendi për të tillët është zjarri, për shkak të asaj që punuan. (Junus 7-8)**

### **Ata nuk mund t'i dinë shpërblimet që vijnë nga dhëmbshuria dhe mëshira**

Dhëmbshuria dhe mëshira janë përbërës të rëndësishëm të një karakteri të moralit të mirë. Ata të cilët e kanë këtë karakter shfaqin këto cilësi, që u japin atyre një kuptim të thellë të kënaqësisë dhe u mundësojnë atyre të fitojnë dashurinë, respektin dhe admirimin e atyre përreth. Mëshira i sjell njeriut akoma më shumë karakteristika të moralit të mirë, dhe kështu ata mund të tregojnë më shumë dashuri, respekt, tolerancë, pjekuri, sinqeritet dhe ndihmë. Dikush që është i mëshirshëm së pari mendon për nevojat e personit tjetër; njerëzit që nuk kanë mëshirë janë zemërfortë dhe së pari mendojnë për vehtvetën. Interesimi i tyre kryesor është t'i qojnë jetërat e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Por, karakteri i tyre i prishur i privon ata nga shumë kënaqësi. Në fakt disa prej tyre bile mund t'mos e vërejnë primivin shpirtëror të cilës iu janë nënshtruar. Vetëm besimtarët u ndihmojnë atyre nëpër rrugë që kanë të ftohtë apo që janë të uritur, ose janë bujar dhe human ndaj atyre që janë të sëmurë. Kënaqësia që vjen nga të pasuarit parimet morale të Kur'anit nuk është si çfarëdo kënaqësi tjetër materiale që ofron bota. Edhe sikur t'u ipeshin miliona dollar, si dhe pronë dhe pasuri, asnjëra nga këto nuk dot mund të krahasojë me kënaqësinë që vjen duke

pasur një karakter të moralit të mirë. Ata shfaqin këtë lloj të parimeve morale për hir të Tij dhe shpresojnë si shpërblim t'fitojnë simpatinë e Tij, dhe shijojnë kënaqësinë, gëzimin, dhe ngacmimin që vjen nga të pasuarit e Kur'anit dhe thënieve të Profetit (s.a.v.s), të cilat janë mbi çdo gëzim tjetër. Por, pabesimtarët nuk mund të shijojnë asnjërën nga këto kënaqësi sepse zemrat e tyre të forcuara nuk përmbajnë mëshirë apo dhembshuri. Natyrisht, disa prej tyre duket se sillen me mëshirë, por presin që edhe të tjerët nga ana tjetër t'jenë të obliguar ndaj tyre ose t'jenë në gjendje të kërkojnë diçka si këmbim për t'mirat që ua kanë bërë. Në Kur'an Allahu na tregon për karakterin e paturpshëm të këtyre njerëzve.

**A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtrojnë përgjegjësinë dhe llogarinën botën tjetër? Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun. Dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfërin. Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe). Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua). (Maun 1-3, 6-7)**

**O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që ia jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk beson All-llahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar bmi të cilin ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin pabesimtar. (El Bekare 264)**

Pabesimtarët, bile edhe shokëve të tyre më të ngushtë iu afrohen me pritjet e njejtë të prishura me shpresën se dot fitojnë ndonjë epërsi. Për shembull, duke qenë se njerëzit bëhen nevojtar materialisht dhe emocionalisht me kalimin e viteve, ata kanë nevojë për dikend që dot kujdeset dhe të interesohet për ta.

Kështu që, pabesimtarët tregojnë interesim, dashuri dhe dhembshuri për t'afërmit e tyre ndërsa llogarisin se çka mund t'u ndodh në të ardhmën. Por ata që nuk kanë karakter të moralit të mirë do të marrin, shpërblimin” për sjelljet e tyre. Atyre do t'u tregohet vetëm dhembshuri e pasinqertë, dhe askush nuk do të formojë miqësi të ngushtë dhe të sinqertë me ta. Njerëzit dot tregojnë për ta dhembshuri vetëm për atë që dot mund të marrin si shpërblim. Kështu që ata e detyrojnë vetvetën të jetojnë në një botë të lire nga vlerat shpirtërore, ku dhembshuria dhe dashuria janë të prishura dhe ku posedimet materiale janë interesimet e vetme të rëndësishme. Në këtë mënyrë, ata pranojnë shpërblime të qarta për karakterin e keq të moralit të tyre. Por, në Kur'an Allahu i përshkruan jetërat e vështira të atyre që e mohojnë si Atë “të errata dhe të ngushta”.

**E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?” Ai (All-llahu) thotë: “Ashtu si harrove ti argumentet Tona që t'i ofruam, ashtu je ti i harruar sot”. Po kështu Ne e shpërblejmë edhe atë që zhytet në mëkate dhe nk i beson argumentet e Zotit të vet, po dënimi në botën tjetër është edhe më i ashpër dhe i përjetshëm. (Ta-Ha 124-127)**

### **Ata i kanë humbur rehatitë e të jetuarit në kënaqësi dhe siguri**

Pabesimtarër jetojnë një jetë me tension dhe pakënaqësi të vazhdueshme, në një botë të mbushur me frikë dhe shqetësim. Ata ecin nëpër rrugë me shprehje të merakut në fytyrat e tyre, të frikësuar se rreziku mund t'u ndodh në çdo moment. Të

moshuuarit shihen qartë të shqetësuar se frigohen se mos dikush do t'i trajton keq. Nevojtarët dhe të varfërit duken të dëshpëruar sepse ata e dijnë se shikohen me përçmim dhe shoqëria nuk ka respekt për ta. Shqetësimi i pastër se do të mashtrohen në çdo moment dhe se do t'u vjedhet pasuria: këto janë vetëm disa nga fytyrat e trazuara që mund të shihen në këtë shoqëri. Kjo është situata në rrugë, por në shtëpi, njerëzit përjetojnë të njejtin tension, në vendin më të afërt ku ata duhej të ndiheshin të sigurt dhe të lehtësuar. Gati çdo ditë, mbrapa dyerve të mbyllura nodhin grindje familjare ku fëmijët trajtohen me humbje durimi, këto janë vetëm dy prej burimeve të tensionit. Situata nuk ndryshon aspak në vendin e punës. Atje është një konkurrencë (rivalitet) në të cilën njëri është jotolerant ndaj tjetrit dhe secili me xhelozzi provon t'a gryej nga themeli tjetrin, si rezultat mbretëron pakënaqësia. Secili në department (zyre) është i tmerruar nga bërja e një gabimi: dhe tensioni më i madh vjen kur provojnë t'i fshehin gabimet që tashmë janë bërë. Shumica nuk mund t'i besojnë shokut më të ngushtë; gjithmonë ekziston mundësia që këta do t'jenë të humbur ose të tradhtuar: dhe kjo ngrit tensione të vazhdueshme.

Çdo kund në botë, fëmijët mund të vjedhin nga familjet e tyre, familjet mund t'i rrahin fëmijë deri në vdekje, dhe njerëzit mund të kryejnë vrasje në rrugë për para pa ngurrar. Për çdo ditë, në television pamjet e frikës dhe tmerrit (horrorit) dramatizohen. Në shumë shtete, terrori dhe dhuna janë bërë gjëra të zakonshme. Vendet e punës ose qendrat tregtare të stërmbushura me njerëz shpeshherë bombardohen, një bank gjoja e siguruar plaçkitet ose menagjeri i përvetëson parat e klientëve, një person mund të jetë jobesnik ndaj bashkëshortës, ndaj shokut të punës, ose ndaj dikujt

që ai apo ajo e ka mbrojtur dhe është kujdesur për të. Gazetat janë plot me tregime të tilla. Kështu, cili është shkaku i gjithë kësaj? Arsyeja kryesore është se njerëzit nuk pasojnë parimet morale të Kur'anit dhe nuk e besojnë Allahun. Sikur njerëzit t'kishin pasur frikë nga Allahu ashtu siq duhej, nuk do t'i trajtonin njerëzit e tjerë padrejtësisht. Gjithkush do t'mendonte mirë për të tjerët, t'i përkrahte dhe do t'sillej moralisht. Kështu nuk dot rezultonte asnjë shqetësim apo tension, kështu që mjedisi i tyre do t'ishte i kënaqshëm dhe i sigurt. Për t'i ikur këtij shqetësimi dhe kësaj frike njerëzit duhet të shprehin besim në Allahun. Shqetësimi dhe tensioni dalin duke mos qenë në dijeni se Allahu kontrollon çdo gjë, dhe duke mos pranuar t'i besojnë dhe t'i nënshtrohen Atij. Ata të cilët jetojnë me shqetësim të vazhdueshëm nuk kuptojnë se Allahu kontrollon gjithçka që ndodh, jo vetëm ata por gjithkënd me të cilin ata janë në kontakt, pa përjashtim. Ata supozojnë se tërmetet, vërshimet, stuhitë e shiut apo zjarret nuk ndodhin vetvetiu pa pasur lidhje me diçka tjetër. Për shkak se iu mungon çfarëdo besimi në Allahun, ata mendojnë se t'gjitha këto katastrofa ndodhin rastësisht ose nga ndonjë fat i keq i imagjinuar. Kjo mënyrë e t'menduarit vetëm se iu lenë tension sepse një, befasi" tjetër e tillë mund të ndodhë në çdo moment. Megjithatë, nuk është zgjidhje t'jetohet me këtë frikë dhe shqetësim të vazhdueshëm. Përkundrazi, kushdo që përjeton një shqetësim të tillë, jeton një ekzistencë shumë të vështirë, të pakënaqshme dhe jo të lumtur dhe nuk mund t'i shijoj gjërat e mira në jetë. Zgjidhja është të besojmë në Allahun. Gjithçka që ndodh në gjithësi është nën kontroll të Tij, dhe Ai ka krijuar gjithçka për t'mirën e shërbyesve të Tij. Ata që kanë besim e dijnë se çdo gjë që duket e mirë, e keqe ose e shëmtuar ka qenë e krijuar

nga Allahu si një test për qeniet njerëzore dhe për t'i shpërblyer ata që bëjnë vepra të mira. Prandaj, pa marrë parasysh se çka u ndodh, ata e dinjë se Allahu do t'i mbron dhe se gjithçka do të mbaroj për të mirën e tyre. Për këtë arsye, ata janë të kënaqur. Ata të cilët e kuptojnë këtë të vërtetë dhe iu nënshtrohen Atij me sinqeritet, Ai do t'i përkrah duke iu qar atyre një ndjenjë të qetësisë nga Prania e Tij:

**Ai është që në zemrat ë besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin. Ushtritë e qiejve e të tokës janë vetëm të All-llahut, e All-llahut është shumë i dijshtëm dhe shumë preciz. (Fet'h 4)**

Çdo ndodhi dhe njeri është nën kontrollin e Tij, dhe mund të ndodh vetëm me lejen dhe dijeninë e Tij. Në Kur'an ne informohemi se askush nuk mund t'i bëjë askujt as keq e as dobi pa lejen e Allahut.

**Nëse All-llahu të provon me ndonjë të keqe, atë s'mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s'ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të, atë që do nga robët e Tij. Ai falë dhe mëshiron shumë. (Junus 107)**

Njohja e kësaj të vërtete i lejon besimtarëve të jetojnë një jetë të sigurt dhe të kënaqshme. Ata pabesimtarë të cilët këmbëngulin në iluzionet e tyre pa e besuar Allahun ose pa iu përmbajtur Kur'anit, nuk mund t'a dinjë kënaqësinë që vjen nga kjo siguri, vetkënaqësi apo lumturi. Kjo është vetëm njëra nga humbjet që Allahu i bënë t'a vuajnë ata në jetën e kësaj bote për shkak se e kanë mohuar Ate.



### **Ata e kanë humbur gëzimin e të jetuarit me shpresë**

Pabesimtarët e konsiderojnë jetën si, një numër i caktuar i fakteve themelore” dhe mendojnë se duke qenë optimist është një mënyrë e të, ngushëlluarit vetvetën”. Në këndvështrimin e tyre, faktet themelore të jetës janë që të pasurit të kenë pushtet ndërsa varfnjakët të jenë të shtypur, dhe që është naive t’ia bëjnë ndonjë të mirë dikujt, se ata që tregojnë të vërtetën shfrytëzohen, dhe se posedimi i dukjeve të mira, parave dhe pozitës mund të hap çdo derë. Sipas kësaj mënyre të shtrembëruar të të menduarit, njerëzit duhet jetuar në këtë botë dhe t’i gjykojnë njerëzit e tyre në përputhje me rrethanat, dhe kështu, ligjet” e tilla përcaktojnë rrjedhën e jetës së njeriut. Dhe, siq thonë ata, këto ligje nuk do të ndryshojnë përderisa bota t’a ndryshoj plotësisht drejtimin. Por, këto të ashtuquajtura fakte të jetës nuk ekzistojnë, faktet e vetme janë ato të cilat i ka shpallur Allahu në Kur’an. Dhe, Ai u thotë qenieve njerëzore të jenë optimist, për shkak se fuqia e Tij mjafton për gjithçka. Ai na tregon se Ai i ndëgjon lutjet tona dhe se ata të cilët bëjnë vepra të mira do të kenë shpërblim më të madh dhe më të këndshëm:

**Dhe vetëm të All-llahut janë ç’ka në qiej dhe në tokë - për t’i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t’i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre. (Nexhm 31)**

Por njerëzit injorant i bazojnë jetërat e tyre në idetë e tyre të mbrapshta që lënë ata në një shpirt pesimist. Ata gjykojnë botën, ndodhitë dhe njerëzit e tjerë nga kjo pikëpamje e dëshpërimit: dhe si rezultat, ata jetojnë jetë jo të lumtur. Kjo mënyrë negative, grindavece e të menduarit pushton ditën e tyre. Ata janë të mbushur me brenga të vazhdueshme për t’ardhmën e tyre. Ata

vazhdimisht brengosen se çka do të ndodh nesër dhe si do të arrijnë ndonjëherë t'i plotësojnë dëshirat dhe aspiratat e tyre. Për këtë temë ata brengosen gati për çdo ditë- në rrugë, autobus, në punë dhe natën kur shkojnë për të fjetur- duke formuar skenare të panumërta të imagjinueshme. Për shembull, edhe përpara se studentët të pranohen në universitet, ata brengosen rreth asaj se si do t'i kalojnë katër vite të tyre atje, dhe bëhen merak për atë se ku do të gjejnë punë pas diplomimit. Pastaj, më herët ose më vonë, ata mundohen t'largohen nga këto dështime të imagjinuara dhe t'i heqin nga mendja. Por pabesimtarët imagjinojnë skenarët më të keqinj: ata mendojnë se nuk do të pranohen në universitetin e zgjedhjes së tyre, e nëse pranohen se nuk dot mund t'ofrojnë këtë, se duhet të kenë punën dhe t'mbaorjnë studimet me vuajtje, se nuk do të diplomohen dhe, edhe nëse po nuk do të gjejnë punë dhe do të mbeten pa ndihmë dhe para pas një mudi kaq të madh. Kjo gjendje shpirtërore negative zgjatë edhe në të ardhmën dhe githashtu në jetën e përditshme. Ata brengosen për çdo gjë: bllokimet në trafik, humbja e autobusit, vonesa në punë, duke qenë të qortuar nga mbikqyrësi i tyre, dhe duke lënë përshtypje të këqija. Ata fillojnë të krijojnë zgjidhje imagjinare për problemet e tyre imagjinare. Për shembull, ata formojnë arsyetime imagjinare për t'u shpjeguar shefave të tyre se përse kanë mbërrirë vonë. Për të treguar se nuk janë dembelë dhe të papërgjegjshëm, ata formojnë më shumë skenarë se çka do të kryejnë pjesën e mbetur të ditës. Por në Kur'an Allahu na tregon se vetëm Ai e din se çka nuk ka ndodhur ende:

**çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjë që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të**

**njomë dhe s'ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (LehviMahfud). (En Nam 59)**

Ai e krijon çdo ndodhi, në të ardhmën dhe të kaluarën. Kështu që është e pakuptimtë që një person të shkruaj skripte n'bazë të imagjinatës së tij dhe të jepet pas frikës së pafund. Gjithçka do të ndodh si të dëshiron Allahu. Në Kur'an Allahu u thot qenieve njerëzorë që kurr mos t'lejojnë vetën të pushtohen nga dëshpërimi.

**(Jakubi u tha të bijëve të vet) O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e All-llahit, pse vetëm populli jobesimtarë e humb shpresën në All-llahun. (Jusuf 87)**

Në një ajet tjetër, Ai na sjell ndërmend se ata të cilët luten Atij do të marrin përgjigje.

**E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua. (Bekare 186)**

Nëse Ai don, me siguri Allahu do t'i përgjigjet një lutjeje të shprehur me shpresë, dhe pa asnjë dyshim dhe frikë. Nuk ka asnjë arsye të jemi pesimist për të ardhmën ose të shiqojmë negativisht gjërat që kanë ndodhur. Njeriu duhet të besoj vetëm në Allahun me zemër të pastër, t'a besoj Ate, dhe t'i nënshtrohet Atij dhe duke e ditur se çkado që ndodh është për të mirën e tyre. Pabesimtarët të cilët refuzojnë t'a bëjnë këtë, do të marrin,, shpërblimin" e një shpirti pesimist dhe të dëshpëruar. Dhe për shkak të mohimit të tyre të qëndrueshëm të Allahut, në botën e ardhshme ata do të jetojnë pa shpresë për shpëtim. Allahu në Kur'an e përshkruan gjendjen e atyre që e mohojnë Ate:

**Ndërkaq, kriminelët janë në vuajtje të përjetshme të Xhehennemit. Atyre as nuk u lehtësohet (vuajtja) dhe aty janë të dëshpruar. 76. Ne nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata vetë kanë qenë horra. (Zuhruf 74-76)**

### **Ata nuk i dijnë shpërblimet e urtësisë dhe mendimit të thellë**

Urtësia është cilësia më e nevojshme, dhe ende gjindet shumë rrallë. Duke u përballur me problemet në jetërat e tyre të përditshme dhe të hutuar nga planet e tyre për të ardhmën, disa njerëz përpqien t'i gjejnë të gjitha hollësitë ashtu si dinë më së miri dhe marrin vendimet më të zgjuara për të shkuar përpara. Kurdo që e ndjejnë që dituria e tyre, përvoja dhe gjykimi janë të pamjaftueshme, ata kërkojnë gjetiu për individë të zguar, të dijshtëm dhe mendjehollë për t'i këshilluar. Por ata nuk mundën gjithmonë të gjejnë individë që ndihmojnë kaq. Dhe këshilla që marrin prej atyre përreth se si t'i zgjidhin problemet gjithmonë është pothuajse e njejtë- kryesisht ngase njerëzit injorant jetojnë jetërat e tyre për t'i kënaqur të tjerët dhe në pajtueshmëri me pritjet e tyre. Në vend se t'kërkojnë ate që është e vërtetë, e mirë dhe e dobishme, ata i përshtasin aspiratat dhe qëllimet e tyre me pritjet (atë që presin t'fitojnë) e atyre përreth dhe jetojnë sipas këtyre kriterëve. Njerëzit e këtillë jetojnë jetëra jopasqyruese.

Një mënyrë e tillë e jetesës nuk le hapësirë për mendime të zgjuara dhe përdorimin e urtësisë. Njerëzit e tillë tashmë e dijnë se ç'do të bëjnë, si do t'ia bëjnë, si do të veprojnë, dhe cilat metoda do t'i përdorin, këshru që stili I tyre jetësor ka kaluar nga gjenerata në gjeneratë. Ata nuk kanë dëshirë t'I ekzaminojnë jetërat e tyre, t'i pranojnë gabimet e tyre, dhe t'I përmirësojnë ato.

Në Kur'an Allahu e përshkruan mënyrën e t'menduarit në një shoqëri injorante:

**E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që All-llahu e shpalli!” Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!” Edhe sikur prindërit e tyre të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)?” (Bekare 170)**

Shumë njerëz janë aq të mësuar me mënyrën e jetesës të cilën e kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre sa që ata as që janë në dijeni për mungesën e zgjuarësisë në çdo aspect të atij stili jetësor: prandaj, ata as që mund të fillojnë të mendojnë se si kishin mundur t'a përmirësonin gjendjen e tyre. Burimi i një urtësie të tillë të nevojshme është besimi. Allahu këtë të vërtetë e shpall në Kur'an:

**O ju që besuat, nëse keni frikë All-llahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t'ua mbulojë të këqiat, do t'ua falë mëkatet. All-llahu është dhurues i madh. (Anfal 29)**

Besimtarët janë në gjendje të përdorin zgjuarsinë e tyre për t'i ndrruar gjërat për të mirë, të zbulojnë zgjidhje radikale dhe të braktisin sjelljet stereotipike. Duke qenë në gjendje të mbërthejnë t'vërtetat e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre, i dhuron njeriut urtësi. Duke qenë se pabesimtarët nuk janë në dijeni për këto të vërteta dhe faktit që jetërat e tyre mbështeten në themele të shtrembëruara, urtësia mungon në shoqëritë e tyre. Shoqërisë injorante, kjo mungesë e urtësisë i sjell edhe një privim (ndalon nga një e mirë) tjetër. Për shkak se këta njerëz nuk përdorin mendjen e tyre, ata janë të detyruar të jetojnë pa elemente krejtësisht të rëndësishme të t'menduarit dhe pasqyrimit. Në

shumë vende në Kur'an Allahu thekson rëndësinë e arsyes dhe zhytjes në mendime. Njerëzit arrijnë deri te e vërteta nëpërmes të menduarit: vetëm duke u zhytur në mendime ata mund të zbulojnë çka është e drejtë dhe e duhur, dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat.

Në Kur'an, Allahu e jep këtë shembull të njerëzve të cilët nuk i përdorin mendjet e tyre.

**Shembulli i (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë. (Bekare 171)**

**Vërtet gjallesat më të dëmshme te All-llahu janë ata të shurdhëtit, memecët, të cilët nuk logjikojnë. (An Anfal 22)**

Koncepti i zgjuarësisë njerëzore përfshinë kapacitetin e të menduarit, përfytyrimit, të gjykuarit, dhe nxjerrja e konkludimeve: aftësia për të kuptuar një ndodhi të rallë dhe të rastësishme dhe të kuptoj, mësoj dhe analizoj: aftësia për t'i zhvilluar (përmirësuar) pesë shqisat, mpreh vëmendjën, thelloj aftësinë e të menduarit, dhe të vërej hollësitë. Si pasojë, ata të cilët janë të privuar nga urtësia mund t'jenë në gjendje të jetojnë dhe të kujdesen për nevojat e tyre pa të, ose t'ia dalin një qëllimi të caktuar duke e ushtruar vehtën duke punuar përmendësh dhe duke e përdorur njohurinë dhe përvojën e tyre të grumbulluar ( akumuluar). Por urtësia u jep njerëzve intenzitet dhe nocion të ndryshëm, dhe e hap një horizont të gjerë para tyre. Këta njerëz pastaj mund t'i udhëzojnë dhe drejtojnë të tjerët te e vërteta, të ragojnë në mënyrë të drejtë ndaj ndodhive të papritura dhe të reja, të zgjedhin problemet e vështira dhe dukshëm të mëdha, dhe gjithmonë të

tregojnë diagnozën më të mirë për secilin problem. Përveq kësaj, duke qenë në gjendje të jetojmë, dashuria dhe besimi mund të vijnë vetëm nga urtësia. Njerëzit mund të dashurojnë dhe të tregojnë respekt vetëm aq sa i lejon urtësia e tyre. Urtësia rrit kualitetin shpirtëror dhe emocional të çdo gjëje në jetë. Ka pasuri në bisedat, qëndrimet dhe veprimet e njeriut të menqur. Horizontet e mendimeve të tyre janë të gjëra, të pamësuar dhe karakteristike dhe është e lidhur me çeshtjën, dhe çdo gjë që thonë është e mençur dhe e vërtetë. Një shoqëri injorante është e privura nga kjo veti jetike dhe e rëndësishme. Në një shoqëri të tillë, njerëzit mbijetojnë jetërat e tyre jopasqyruese pa ushtruar urtësi; në një botë ku psikologjia masive përcakton se ashtu si ndihen ashtu duhet të veprojnë. Siç duket, kjo i ndalon ata për të qenë në dijeni për- apo bile edhe për të ekzaminuar mangësitë e tyre: ata nuk mund të zhvillojnë zgjedhje të qëndrueshme për problemet e tyre dhe ata gjithmonë kërkojnë lumturinë dhe kënaqësinë në vend të gabuar.

### **Ata i kanë humbur shpërblimet që vijnë duke qenë i ndershëm, dinjitoz dhe i nderuar**

Pabesimtarët i respektojnë të tjerët në bazë të vlerave të caktuara materiale. Por, ky respekt është i remë dhe bazohet në dëshirën për të siguruar përfitim nga dikush. Virtytet që urdhërojnë respektin e vërtetë janë të paimitueshme dhe të pamatshme sa i përket vlerave materiale. Ndër këto virtyte janë ndershmëria, dinjiteti dhe nderi dhe që të gjitha këto i japin njeriut vlerë dhe rëndësi, dhe përbrenda tyre zgjojnë dashuri dhe respekt. Asnjë shumë e pasurisë, bukurisë, dhe rëndësisë nuk mund të shkaktojnë respektin e ndier ndaj një personi të

ndershëm, dinjitoz, dhe të nderuar. Njerëzit e tillë janë prej natyre dinjioz dhe madhështor me fisnikëri dhe thellësi të zemrës. Por, pabesimtarët nuk mund t'i përjetojnë këto kënaqësi apo t'i admirojnë ata të cilët i posedojnë këto cilësi të mira. Degjenerimi I tyre moral rritet përditë, dhe shoqëria e tyre i bënë t'a harrojnë rëndësinë e këtyre cilësive të mira. Disa pabesimtarë këtë degjenerim e konsiderojnë si modernizim dhe, në vend se t'i praktikojnë këto virtyte, përqëndrohen në ato kualitete të kësaj bote që do t'u jepin autoritet në sytë e njëri tjetrit. Ata nuk vëjnë rëndësi në dinjitet dhe ndershmeri, për këtë është më me rëndësi se ku jetojnë, çfarë lloji të automjetit ngasin, se a e përcjellin modën më të fundit të rrobeve, ose a i kanë albumet më të reja. Kur vjen te zgjedhja e shokëve, gjëja e fundit që kërkojnë tek ai është karakteri moral i personit, dinjiteti, dhe nderi. Disa njerëz të cilët injorojnë parimet morale të Kur'anit nuk dëshirojnë që shokët e tyre t'a vlerësojnë ndershmërinë ose të veprojnë me dinjitet dhe nderë Për këtë arsye, ata preferojnë shokë që janë si vetë ata. Natyrisht, njerëzit e tillë nuk mund t'a respektojnë njëri tjetrin; më tepër, ata sillen ndaj njëri tjetrit në mënyra të pahijshme dhe grindavece që nxjerrin në shesh degjenerimin e tyre moral. Kjo është vetëm njëra nga irritimet e tyre periodike të cilën ua sjell morali i tyre i pahijshëm (paturpshëm). Gjithashtu pabesimtarët e kanë humbur tërë nderin. Ata nuk përgjigjen me pjekuri kur përballen me qëndrimet injorante, ose nuk ngurrojnë të gënjejnë, të jenë dyfytëresh, të sillen në mënyra të pahijshme, ose të bëjnë mashtrime për përfitime të vogla. Ata mendojnë se mund të fitojnë nderë duke pasur para, prona dhe pushtet, duke qenë arrogant, duke u begenisur nga të tjerët, dhe duke përdorur pasurinë për t'u dukur më i lartë se të tjerët. Kështu, pasi kanë



humbur ndershmërinë, dinjitetin dhe nderin, ata jetojnë në një botë të mbizotëruar nga vlerat mareriale. Thjeshtë çfarë jete i ofron atyre një botë e tillë?

Mbi të gjitha, përkundrazi nga supozimet e tyre, degjenerimi moral nuk u sjell atyre rehati dhe liri. Përkundrazi, t'jetuarit e jetës në shkallën më të lartë me dëshira të shfrenuara materiale i largon krejt cilësitë që e bëjnë një individ të njerëzishëm dhe më të keq, rezulton në një model të shoqërisë që i tërhjek njerëzit poshtë në kaos dhe boshllëk. Të rinjtë të cilët e humbin rininë e tyre duke përcjellur modë të mbrapsht, duke u dhënë pas drogës që shkatërron jetën e tyre dhe që sjellin vehtë në anë të vdekjes, janë vetëm një shembull i shtrirjes së këtij kaosi. Të gjitha këto gjëra janë të shkaktuara nga zbrazëtia në shpirtin e këtij personi. Duke besuar se mund të jetojnë pa ndershmëri, dinjitet dhe nderë si dhe pa pasur nevojë të zhvillojnë një karakter të moralit të mirë duke pasuar parimet morale të Kur'anit dhe duke praktikuar virtytet njerëzore, ata dështojnë në të dyja anët fizikisht dhe shpirtërisht. Boshllëku në shpirtërat e tyre reflekton në fytyrat e tyre, pamjet, bisedat dhe sjelljet. Forca e tyre fizike i braktis dhe fytyrat e tyre të bukura nuk ngjallin admirimin e askujt, dhe asgjë nga shpirti i tyre dhe nga boshllëku i brendshëm shpirtëror i tyre nuk mbetet pa u reflektuar në fytyrat dhe sytë e zbrazët. Të sunduar nga kjo zbrazëti shpirtërore, ata nuk mund të sigurojnë kualitetet të cilat joshin dashuri të vërtetë, respekt dhe besnikëri. Dhe kështu ata nuk mund vërtetë të dashurojnë, t'jenë shokë të vërtetë ose t'a vlerësojnë dikend tjetër. E tëra kjo ndodh sepse njerëzit injorant e kanë ndarë vetën nga mësimet e Kur'anit për moral. Ky është rezultati natyror i mungesës së frikës nga Allahu; kjo është ajo që ndodh kur njerëzit nuk veprojnë në bazë të

ndërgjegjieve të tyre, dhe nuk i kushtojnë mjaftë rëndësi një karakteri të moralit të mirë dhe cilësive që i sjell ajo. Mësimet e Kur'anit për moralin janë e vetmja zgjidhje për këto dështime njerëzore. Vetëm duke jetuar sipas parimeve morale që Allahu i ka shpallur mundet një individ të dashuroj, të jetë i dashur nga dikush, t'jetë i lumtur dhe t'i shijoj bukuritë e kësaj jete.

### **Të jetuarit për të fituar simpatinë e Allahut; një gëzim të cilin pabesimtarët nuk mund t'a përjetojnë asnjëherë**

Pabesimtarët i qojnë kot jetërat e tyre duke vrapsuar pas jetës së kësaj bote prandaj e humbin kënaqësinë e thellë që vjen duke i pasuar parimet morale të Kur'anit dhe shpresën për dashurinë, shoqërinë, dhe miqësinë e ngushtë të Tij. Shumica e njerëzve asnjëherë nuk e kanë ndjerë një ndjenjë aq të thellë. Allahu është miku më i ngushtë i besimtarëve, ndihmësi dhe përkrahësi i vetëm, dhe i dashuri i vetëm, kështu ata e dedikojnë vehtën për t'fituar simpatinë e Tij. Prej momentit kur një besimtarë zgjohe në mëngjes, ai e kalon gjithë kohën e tij duke u sillur me moralin që Allahu e pëlqen, me shpresa se do të fitoj dashurinë e Tij. Për një person me besim, të vepruarit në çdo moment për t'a kënaqur Allahun është një burim i gëzimit dhe kënaqësisë së madhe. Në të njëjtën mënyrë, duke i shmatur sjelljet që nuk e kënaqin Ate, duke mos e kompromentuar asnjëherë besimin dhe lidhjen me Të, prodhon një kuptim të lumturisë së thellë në zemrën e besimtarit. Një besimtarë besnik gjatë gjithë jetës së tij mundohet të bëhet një njeri që Allahu e don më së shumti, një njeri me të cilin Ai është më se i kënaqur, dhe të jetë më së afërti me Ate. Kënaqësitë që këto përpjekje i sjellin nuk mund të krahasohen me kënaqësinë që çfarëdo bekimi i kësaj bote mund të sjell. Në Kur'an Allahu shpall:

**Kush ka fe më të mirë se ai që singerisht i është bindur All-llahut dhe, duke qenë bamirës, e ndjek fenë e drejtë të Ibrahimit? All-llahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin më të ngushtë. (Nisa 125)**

Besimtarët pasojnë shembullin e profetëve. Në mënyrë që të jenë të denjë për bekimin e miqësisë që Allahu i dha profetit Ibrahim (a.s) dhe të jenë afër Tij, ata i qojnë jetërat e tyre duke e ndjekur këtë miqësi të ngushtë. Për ata që e mbajnë besimin e tyre, Allahu shpall si në vijim:

**All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur Xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh. (Tewbe 100)**

Një njeri me besim do të bëjë gjithqka që mundet për t'u bërë njeriu që Allahu e përshkruan në Kur'an, në mënyrë që t'a kënaqë Ate. Gëzimi që përpjekjet e tyre të sinqerta krijojnë në shpirtin e tyre, si dhe ndjenja e kënaqësisë (të qenit i kënaqur) dhe sigurimit që ajo u sjell në ndërgjegje, i japin atyre një kënaqësi të madhe. Të gjitha këto janë kënaqësi që besimtarët do t'i shijojnë përgjithmonë në botën e ardhshme. Allahu shpall (njofton për) lajmet e mira të mëshirës, pëlqimit (aprovimit) dhe Parajsën për shërbyesit e Tij.

**Thuaj: “A t’ju lajmëroj për diç shumë më të mirë se ato? Për ata që frikësohen , ata kanë te Zoti i tyre Xhennete nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë bashkëshorte të pastra , dhe kënaqësi nga All-llahu. All-llahu është Basir (Ai që sheh çdogjë) për robërit. (Ali Imran 15)**

Por njerëzit injorant jetojnë duke mos qenë në dijeni që këto begati ekzistojnë fare. Ata nuk e ndëgjojnë ndërgjegjën e tyre dhe në vend të kësaj, ndjekin pasionet dhe dëshirat e vehta; si rezultat, ata janë të privuar nga të gjitha të mirat e tanishme dhe ato të ardhshmet. Dhe siq është rasti me begatitë e tjera, privimi i tyre do t'zgjasë në botën e ardhshme aq kohë sa të dëshirojë Allahu.

## Është e mundshme t'i kthejmë këto kënaqësi të humbura

**S**humë njerëz shprehen se nuk janë të lumtur, edhe pse kanë bekime (begati) të mrekullueshme si dhe mjetet për t'u kënaqur me to dhe e konsiderojnë jetën si përplot me vështërësi dhe shqetësime. Por, gjatë jetës së tyre, ata duhet të ndalen dhe t'a pyesin vehtën se ç'janë duke bërë, cilat janë qëllimet e tyre dhe ku janë duke shkuar. Ata duhet konsideruar se jeta në mes të këtyre gjërave aq të kënaqshme dhe të mrekullueshme nuk duhet t'jetë aq e vështirë, e dhimbshme dhe jo e lumtur. Ata duhet kërkuar burimin e zbrazësisë në shpirtin e tyre dhe pakuptueshmërisë së jetërave të tyre dhe duhet t'a kuptojnë se duke humbur edhe më shumë kohë veçse do t'a shtoj hidhërimin (jolumturinë) e tyre. Edhe pse jetërat e tyre i bazojnë në përdorimin më të mirë dhe më të kënaqshëm të burimeve të tyre, duhet t'a kuptojnë se ekziston një arsye e posaçme se pse nuk mund të jenë të lumtur dhe t'i gëzojnë begatitë e tyre. Ata duhet shiquar këtë si pjesë të mëshirës dhe dhembshurisë së

Allahut, e cila është e përcaktuar për t'u dhënë atyre mundësi të panumërta për t'u kthyer Atij dhe të përcjellin parimet morale të Kur'anit. Ata nuk duhet filluar të mendojnë rreth këtyre gjërave kur t'kenë humbur gjithçka dhe kur vdekja t'u afrohet, bile më mirë t'a bëjnë këtë herën e parë që Ai u tregon të vërtetën dhe paralajmëron ndërgjegjën e tyre. Kur të vijnë tek kjo pikë, nëse janë të sinqertë Allahu do t'u tregoj atyre rrugën e drejtë dhe çka duhet të bëjnë. Meqenëse Ai I është Gjithëdijshëm dhe më afër tyre se sa vena e qafës ( jugulare), Ai do të dijë se çka dëshirojnë dhe kërkojnë, dhe do t'u tregoj rrugën e duhur dhe si t'i shmangin shqetësimet e tyre. Megjithatë, nëse njerëzit nuk ndryshojnë atëherë është faji i tyre kështu që;

**Çfarëdo e mire që të vjen është nga All-llahu, e çka të ndodhë nga ndonjë e keqe është nga vetë ti. Ne të dërguam ty Pejgamber për mbarë botën. Mjafton që All-llahu është dëshmues për këtë. (Nisa 79)**

Në një ajet tjetër, Ai thotë se nëse një njeri dëshiron t'a ndërroj gjendjen e tij, ai së pari duhet t'a bëjë një ndryshim të sinqertë në zemrën e tij:

**Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase All-llahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase All-llahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë). ( Enfal 53)**

Në momentin që njerëzit vendosin të ndryshojnë dhe sinqerisht të ekzaminojnë vehtën dhe më pastaj t'a ndryshojnë mënyrën e të menduarit, Allahu do t'a dijë dhe do t'i ndryshoj begatitë e Tij mbi ta kështu falja dhe zemërgjërësia e Tij janë infinite (pa kufi) dhe mëshira e Tij është e pamasë.

**Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që u shpjegojnë njerëzve, (të vërtetën), të tillëve ua pranoj pendimin, se Unë pranoj shumë pendimin, jam mëshirues. (Bekare 160)**

Kur njerëzit t'i pasojnë parimet morale të Kur'anit , pavarësisht se çka kanë bërë në të kaluarën, Ai do t'u fal, do t'iu ndryshojë të këqijat e tyre në të mira, dhe si shpërblim për karakterin e moralit të mirë të tyre, për ta krijon në këtë botë mirësi dhe bukuri që do të vazhdojnë në Parajsë:

**Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten. (Bekare 112)**

**Ndaj All-llahuua u dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër; All-llahu i do punë mirët. (Ali Imran 148)**

**Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në ditën e gjykimit) shpërblehet dhjetë fish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të. Atyre nuk u bëhet e padrejtë. (Enam 160)**

**Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me të ardhur të peygamberëve) dhe lutnie Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën. S'ka dyshim se mëshira e All-llahut është pranë atyre të mirëve. (Al Araf 56) Dhe fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e aërta (me ditën) të natës. S'ka dyshim se vepra e mira i shlyejnë ato të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që pranojnë këshillat. Dhe ti, jij i durueshëm, se All-llahu nuk ua humb shpërblimin bëmirsve. (Hud 114-115)**

**Përveç ati që është penduar dhe ka bërë veprë të mirë, të tillëve All-llahu të këqiat ua shëndruron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë. (Furkan 70)**

**Kush ka bërë veprë të morë, ati do t'i takojë (shpërblim) edhe më i mirë se ajo dhe ata do të jenë të siguar prej tmerrit të asaj dite. (Neml 89)**

**Thuaj: “O robërit e Mi që keni besuar, kini frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjërë, ndërsa të durueshmive u jepet shpërblimi i tyre pa masë!” (Zumer 10)**

**Ajo (dhunti) konsistonnë atë që All-llahu u jep myzhde robërve të vet, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira. Thuaj: “Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time vetëm respektin e dashurisë për hir të farefisnisë (akraballëkut)”. Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mira; vërtet, All-llahu falë mëkatet, është mirënjohës. (Shura 23)**

**E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët. (Jusuf 22)**

Allahu do t'u shpall rrugën e vërtetë atyre të cilët e kërkojnë ate me sinqeritet dhe do t'i ndihmoj ata në kërkimin e saj.

Ai do t'a largoj frikën, errësirën, dëshpërimin dhe shqetësimin që dikur mbizotëronte jetërat e tyre dhe do t'a zëvendësoj me vetëkënaqësi dhe siguri. Kushdo që e sheh këtë të vërtetë iu nënshtrohet Allahut dhe Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtomie nimetin e All-llahut ndaj jush, kr ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të



greminës së Xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua shqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. (Ali Imran 103)

Dhe duhet t'a dijnë se: E kush ia dorëzon veten All-llahut duke qenë edhe punëmirë, ai është kapur për lidhjen më të sigurt dhe vetëm te All-llahu është përfundimi i çështjeve. (Llukman 22) nuk do të vuan fatkeqësi që Allahu nuk e dëshiron, dhe do t'jetojë jetën më të mirë të mundshme në këtë botë dhe në Parajsë, duke shijuar kënaqësitë më të mëdha prej të gjitha begative të Tij:

**Nëse All-llahu të provon me ndonjë të keqe, atë s'mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s'ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të, atë që do nga robët e Tij. Ai falë dhe mëshiron shumë. (Junus 107)**

**Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre (Nahl 97)**

## Vdekja: Momenti kur mbarojnë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote

**C** dokush që është i lidhur për kësaj bote e dinë, por do t'preferonte të harojë, se çdo kush do të vdesë një ditë. Vdekja do të fshijë gjithçka që kanë bërë për t'a themeluar një jetë të bazuar në vlerat e kësaj bote.

Vdekja do të zhbëjë vitet e gjata të zotërimeve të mahnitshme dhe fitimin e admirimit nga njerëzit e tjerë. Një individ mund të jetë i pasur, tërheqës, i respektuar dhe i mirënjohur, por për një moment ai do të humb tërë pasurinë materiale. Për një kohë të shkurtër trupi i tij do të prishet deri në atë vend ku askush nuk dëshiron t'iu afrohet; pastaj do të varroset në tokë për t'u kalbur. Ky është përfundimi për të cilin një pabesimtarë shpenzon dekada duke u përpjekur drejt arritjeve të tij në këtë botë. Duke jetuar një jetë të mbushur me dëshira të kësaj bote duke u lodhur për t'shijuar çdo kënaqësi deri në fund nuk do bëjë asgjë që t'a ndrojë përfundimin e një njeriu. Vdekja do t'i fshijë të gjitha këto kënaqësi. Vdekja do të jetë një moment ku të gjitha dëshirave dhe pasioneve të një njeriu i cili e ka mohuar Allahun do t'u vie fundi;

pas atij momenti ai do t'fillojë një jetë të përhershme të mundimit dhe brengës. Allahu na lajmëron se çka do të përjetojnë ata:

**E si do të jetë atëherë puna e tyre engjëjt t'ua marrin shpirtin duke i rrahur fytyrave dhe shpinave të tyre? (Muhamed 27). E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Zotit, ose thotë: “Mua po më shpallet e nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë: “Do të thur diçka të ngjajshme me atë që e ka zbritur All-llahu”. E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): “Shpëtonie pra vetveten (nëse mundeni)”. “Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun, dhe ndaj argumrnteve të Tij ishit kryeneç. (En'am 93)**

**E t'i puqet kofsha për kofshe (t'i vështirësohet gjendja). Atë ditë vetëm te Zoti yt shkohet. E ai as nuk vërtetoi atë që duhej, as nuk u falë. Por përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën. Dhe shkante te familja e tij me fodullëk. Të është afruar ty e keqja e t'u afroftë! (ose i mjeri ti i mjeri). Edhe nje herë t'u afrua ty e keqja; t'u afroftë! (Kijame 29-35)**

Nga kjo mund të kuptojmë se vdekja është një realitet i pamohueshëm dhe, po të mos dojë Allahu ndryshe, do të jetë fillimi i një agonie të përhershme për të gjithë ata që e mohojnë Ate. Por, disa njerëz mundohen të mendojnë për vdekjen sa më pak që është e mundshme përderisa janë të gjallë; ata dëshirojnë t'a harrojnë dhe mos t'a përmendin atë. Kështu është, përderisa vdekja të vie... Më në fund, duke e kuptuar se i kanë kaluar jetërat e tyre të tëra duke shtypur ndërgegjën dhe duke e mohuar realitetin e vdekjes, ata menjëherë gjejnë strehim tek Allahu, duke shpresuar të gjejnë shpëtim. Por ata janë vonuar shumë, kështu :

**Dhe kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt qëndrojnë rradhë-rradhë!  
Dhe atë ditë sillet Xhehennemi, ditën kur përkujtohet njeriu,  
e ç'dobi i bën atij përkujtimi? Thotë: "O, i gjori unë, sikur  
të isha i parapërgatitur për jetën time!" (Fexhr 22-24)**

Allahu u jep njerëzve një jetë (kohë gjatë tërë jetës) që ta shohin rrugën e vërtetë dhe t'a dinjë mëshirën e Tij. Ata të cilët refuzojnë t'a shfrytëzojnë këtë do të pendohen për vendimet e tyre:

**Dhe ata do të klithin aty: "O Zot ynë, nxirrna e të bëjmë  
vepra të mira, e jo si ato që i bënim!" Po a nuk u dhamë juve  
jetë aq sa që ai ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë  
gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe pejgamberi,  
pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.  
(Fatir 37)**

Njerëzit duhet ditur se Allahu nuk do t'i pranoj përgjërimitet e atyre të cilët bëjnë pendim vetëm në shtratin e vdekjes. Për këtë arsye, gjithkush duhet patur parasysh përkujtuesit e Allahut gjersa ka ende kohë dhe t'u nënshtrohet Atij para se t'arrijë momenti i paevitueshëm dhe i pakthyeshëm. Nëse një person e bënë shijimin e kënaqësive të kësaj bote synim të tijin, ai duhet t'a ketë parasysh, edhe nëse nuk dëshiron, se pa dyshim, një ditë këto gjëra padyshim do të përfundojnë. Kur jetëgjatësia që Allahu ia ka dhuruar një individit të mbaroj, të gjitha kënaqësitë që ai i ka ndjekur do t'a humbin vlerën e tyre, ato do të kalben në tokë së bashku me trupin e tyre. Kjo është një e vërtetë e qartë të cilën gjithkush duhet t'a kuptoj. Veç kësaj, ata duhet kuptuar se mohimi i Allahut sjell veçse brengë (jolumturi) në këtë botë, pendim në çastin e vdekjes, dhe agoni në botën e ardhshme, kurse besimi sjell një thellësi të shpirtit i cili u mundëson atytre t'i

shijojnë kënaqësitë e kësaj bote në nivelin më të lartë dhe kënaqësi me bollëk përgjithmonë në jetën e përtejme. Njerëzit duhet t'a shohin dallimin në mes të këtyre dy gjendjeve dhe duhet t'u nënshtrohen dritës Hyjnore të besimit për t'i ikur errësirës së mohimit.

Në këtë libër mbi zbrazëtinë dhe brengën e pabesimtarëve, harxhimin e kënaqësive të tyre, dhe pakuptueshmërinë e jetërave të tyre ne kemi siguruar mjetet / mënyrat që ata të kërkojnë të vërtetën dhe t'i nënshtrohen Allahut. Me shpresë, ata do të pasojnë parimet morale të Kur'anit përpara se të përballen me vdekjen. Allahu na tregon se pabesimtarët do të dëshirojnë të kishin besuar. Por, kjo nuk do jetë më e mundshme pas vdekjes.

**Ata që nuk besuan shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë myslimanë. Leri (Muhammed) ata, të hanë, të dëfrehen dhe t'i preokupojë shpresa (se do të jetojnë shumë), e më vonë do të kuptojnë. (Hixhr 2-3)**

## **Begatitë e humbura në botën e ardhshme**

Ata që për një vlerë të paktë e shesin besën e dhënë All-llahut, ndryshojnë edhe zotimet e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë) në botën tjetër, dhe në ditën e kijametit All-llahu nuk u flet atyre, nuk i shikon ata dhe i pastron (prej barrës së gabimeve), ata kanë një dënim të dhembshëm. (Ali Imran 77)  
Ai thotë: “Heshtni aty e mos më folni!”. (Mu’minun 108)

### **Ata as nuk do të jetojnë e as nuk do të vdesin**

I cili do të hyjë në zjarrin e madh. Pastaj nuk do të vdesë në të, por as nuk do të jetojë. (A’ëla 12-13)

Përpiqet ta përbijë, po nuk mund ta gëlltis atë, atij i vjen vdekja nga të gjitha anët (sipas shenjave shkatërruese), po ai nuk vdes (e të shpëtojë prej vuajtjeve), atë e pret dënim shumë i rëndë. (Ibrahim 17)

### **Ata të cilët në këtë botë kanë dëshiruar të jetojnë përgjithmonë, atje do të dëshirojnë të vdesin**

E kur të hudhen duarlidhur në një vend të ngushtë në të, aty do të kërkojnë shkatërrimin (vetëzhdukjen). (Furkan 13)

**Ata do t'i kenë humbur të gjitha shpresat**

Atyre as nuk u lehtësohet (vuajtja) dhe aty janë të dëshpruar. (Zuhruf 75)

E ditën kur të ndodh kijameti, kriminelët heshtin. (Rrum 12)

**Në vend se të jetojnë në kënaqësi (mjaftueshmëri) dhe siguri, ata do të jetojnë në fatkeqësi dhe konflikt**

Kjo armiqësi në mes banuesve të zjarrit është e vërtetë. (Saad 64)

E duke u grindur mes vete në të, ata thonë: “Pasha All-llahun, njëmend ne kemi qenë krejtësisht të humbur”. (Shuara 96-97)  
Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkjimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar. (Kahf 28)

**Ata do të jenë jo të lumtur përgjithmonë**

Që aty nuk hyn tjetërkush, pos atij që është më i prishuri. (Lejl 15)

**Ata kurrë nuk do t'a kenë një shok të mirë dhe të sigurtë: shoku i vetëm i tyre do të jetë Zjarri**

E tash për ne nuk ndonjë ndihmës (ndërmjetësues). Nuk ka as ndonjë mik të sigurtë. (Shuara 100-101)

E ata që i konsideruan të rreme faktet tona dhe kryelartësi u larguan prej tyre, ata janë banues të zjarrit dhe në të janë përjetë. (Al Araf 36)

**Ata do të jetojnë përgjithmonë me keqbërësit (mizorët)**

E kur u shkon shikimi i tyre nga ata të Xhehennemit, Thonë: “Zoti ynë mos na bë neve me mizorët!” (Al Araf 47).

**Lajmet e mira do të jenë për ta të ndaluara**

Për kriminelët atë ditë kur i shohin engjëjt nuk ka gëzim, sepse ata (engjëjt) u thonë: “Është e ndaluar çdo e mirë (apo Xhenneti është haram për ju!)” (Furkan 22)

**Ata nuk do të dijnë për dashurinë dhe respektin; ata do të jenë të përbuzur dhe të shihen me përçmim**

Ditën kur me rrëmbim shtyhen në zjarrin e Xhehennemit. (Tur 13)

Ata do të tubohen, do të jenë të përmbysur me fytyrat e tyre në Xhehennem, të tillëve u përket vendi më i keq, ndaj ata janë më të humburit në rrugën e tyre. (Furkan 34).

Zoti ynë, atë ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; oë mizorët nuk ka ndihëtarë! (Ali Imran 192)

**Ata do të dëshirojnë dritë por nuk do t’jenë në gjendje t’a gjejnë ate**

Ditën kur hipokritët dhe hipokritet atyre që besuan u thonë: “Na pritni (ose na shikoni) të ndriçohemi prej dritës suaj!” U thuhet: “Kthehuni prapa jush (në dynja) e kërkoni ndonjë dritë!” Atëherë vihet ndërmjet tyre njëfarë muri që ka një derë, e brendia e tij është mëshirë (Xhenneti), e ana e jashtme e tij është dënimi (zjarri). ( Hadid 13).



**Ata do t'a kenë shtëpinë më të keqe**

Në ditën kur zullumqarëve nuk u bën dobi arsyetimi i tyre, ata janë të mallkuar dhe ata e kanë vendin e keq. (Gafir 52)

**Ferri do të jetë shtrati dhe mbulesë krevati i tyre**

Për ata është përgatitur shtrat nga zjarri dhe mbulojë (nga zjarri). E kështu pra i shpërblejmë zullumqarët. ( A'ëraf 41)

**Ata do t'jetojnë në vende të errëta, të trubullta**

Dhe në errësirë tymi. As e freskët e as e këndshme. (Vakia 43-44)

**Ata do t'a gjejnë vehtë në vende të ngushta dhe të kufizuara**

E kur të hudhen duarlidhur në një vend të ngushtë në të, aty do të kërkojnë shkatërrimin (vetëzhdukjen). (Furkan 13)

**Ata do të tubohen të verbër**

Ditën kur i fryhet surit (bririt), atë ditë Ne i tubojmë mëkatarët symavijosur (të verbër, të shëmtuar). (Taha 102)

**Ata kurrë nuk do të gjejnë qetësi dhe freskim**

Aty nuk do të shijojnë as freskim, as ndonjë pije. Përveç ujë të valë e kalbësirë. (Nebe 24-25)

Dhe në errësirë tymi. As e freskët e as e këndshme. (Vakia 43-44)

**Ata do t'i humbin pamjet e tyre të bukura dhe do të shëmtohen; ata do të marrin një pamje të neveritshme**

Edhe në këtë botë ikemi përcjellë ata me mallkim, kurse në ditë e kijametit ata janë të përbuzur. (Kasas 42 )

Atë ditë ka fytyra edhe të vrazhda. (Kijame 24)

E ata që bënë gënjeshtër ndaj All-llahut, do t'i shohësh në ditën e kijametit, fytyrat e tyre të nxira. A nuk është në Xhehennem vendi i Kryelartëve? (Zummer 60).

Me shikimet e tyre të përulura i ka kapluar poshtërimi. Ajo është dita që ka qenë premtuar. (Marixh 44).

**Të gjitha begatitë dhe të gjitha llojet e ushqimeve që gjinden në Parajsë janë të ndaluara për ta**

Banuesit e zjarrit i thërrasin (dhe i lusin) ata në Xhennet (duke ju thënë): “Na qitni diç nga uji apo nga ajo që u ka dhënë All-llahu (se mbaruam nga etja)!” Ata (në Xhennet) thonë: “All-llahu i ka ndaluar që të gjitha këto për jobesimtarët!” (A’ëraf 50)

**Ata do të jetojnë në frikë**

E ti kurrsesi mos e mendo All-llahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët; Ai vetëm është duke i lënë ata përderisa një ditë në të cilën sytë shtangen (mbesin të hapur). 43. (atë ditë) Ata të ngutur e duke i ngritur kokat e tyre lar, nuk lëvizin sytë e tyre ( për të shikuar), e zemrat e tyre janë të zbrazura (nga frika). (Ibrahim 42-43)

Me shikimet e tyre të përulura i ka kapluar poshtërimi. Ajo është dita që ka qenë premtuar. (Ma’arixh 44).

**Ushqimi i vetëm i tyre do të jetë uji I vluar, gjaku, qel bi dhe zjarri**

Pastaj, ata do të kenë kundrejt atij ushqimi edhe ujë të valë.  
(Saffat 67)

**E pas tij (kryelartit) është Xhehennemi, në të cilin i jepet ujë të ndyrë (që rrjedh prej lëkurave të djegura)**

Përpiqet ta përbijë, po nuk mund ta gëlltis atë, atij i vjen vdekja nga të gjitha anët (sipas shenjave shkatërruese), po ai nuk vdes (e të shpëtojë prej vuajtjeve), atë e pret dënim shumë i rëndë. (Ibrahim 16-17)

E menjëherë pas do të pini pre ujit t vluar! 55. Do të pini si deveja e etshme!” (Vakia 54-55)

Ky është ujë i valë dhe i ndyrë; le ta shijojnë atë! (Saad 57)  
As ushqim tjetër përveç të të shplarave. (Qelbit të kulluar)  
(Hakka 36)

Ata që fshehin nga libri atë që shpalli All-llahu dhe për të fitojnë shumë të paktë, ata në barqet e tyre fusin vetëm zjarr. Atyre All-llahu nuk do t’u flasë në ditën e gjykimit dhe as nuk i shfaqson ata, por për ta pason dënimi i rëndë e i padurueshëm. (Bekare 174)

**Në vend të begative të Parajsës ata do të hanë Zekum dhe shkurre të hidhëta me gjemba**

Është e vërtetë se pema e Zekumit, Do të jetë ushqim i mëkatarëve. vlon si katran (si pezhgeja) në barqet. Ashtu si vlon uji i valë. (Duhan 43-46).

**A kjo pritje (me shpërblim të All-llahut) është më e mirë, apo pema e “Zekumë-it”? Ne atë e kemi bërë sprovë për zullumqarët. Ajo është një pemë që mbin në fund të Xhehennemit. Pema (fruti) e saj është sikurse kok a dreqërish. (Saffat 62-65)**

**Keni për të ngrënë prej pemës Zekumë! Prej saj keni për t'i mbushur barqet! (Vakia 52-53)**

**Edhe ushqim që nuk gëlltitet edhe dënim të dhembshëm. (Muzzemil 13)**

**Ata kanë ushqim tjetër pos një barishte me ferra helmuese. Që as nuk jep fuqi, as nuk largon uri. (Gashije 6-7)**

## Përfundim

**K**udo që të jesh pikërisht në këtë moment, ndalu dhe hidhe një sy përreth. Mundohu me sinqeritet të kuptosh bukurinë që të rrethon pa humbur asnjë pjesë të saj. Mendo për begatitë dhe mundësitë që ke, dhe mendo për ata që janë më keq se ti. Së shpejti, ju do të vëni re se mund të shihni gjëra edhe më të bukura dhe të mbërtheni hollësitë, dhe se ju mund të argëtoheni me ate që keni rreth jush shumë më tepër se sa që keni paramanduar ndonjëherë. Është një begati e madhe të mund të marrësh frymë lirisht, dhe të kënaqesh me shijën e ushqimit tend të preferuar, dhe kur t'jesh i lodhur të zgjatesh dhe të flesh gjumë të rehatshëm. Është e mrekullueshme të mund t'i shijosh të gjitha këto begati gjatë gjithë kohës pa menduar fare për këtë. Nuk i ka gjithkush të njejtat begati, por atyre që u mungojnë (psh.shëndeti), në mëshirën e Tij të pakufi, Allahu u jep begati të tjera. Ata të cilët janë të lumtur, që e kuptojnë këtë për here të parë dhe që kanë një gëzim të thellë në shpirtin e tyre, duhet t'a dijnë se kjo jetë përmban shumë më shumë gjëra të mrekullueshme. Ndoshta ata nuk kanë marrë kurrë parasysht këto begati për shkak të gjendjes mendore pesimiste që rrjedh nga mosbesimi. Ndoshta ata kurrë nuk i kanë kuptuar se sa të

rëndësishme janë këto begati të mrekullueshme. Ata mund t' mos e shohin se Ai ka krijuar gjithçka për kënaqësinë, rehatinë dhe lumturinë e njerëzimit; ata mund t' mos e kuptojnë se ata duhet t' a falemnderojnë Ate. Edhe nëse kanë qenë të pavëmendshëm, e kaluara a tyre do të fshihet në qoftë se ata me sinqeritet e pranojnë këtë të vërtetë dhe iu nënshtrohen Atij. Ai i krijoi ata, i mbron dhe i mban; Ai i mbulon ( si rrebesh shiu) ata me dashuri, dhembshuri dhe mëshirë dhe u dhuron atyre begati të panumërta. Si shpërblim ata duhet jetuar në mënyrën që e kënaqin Ate. Ata duhet t' a dëjnë se jeta e tyre do të ndryshoj pas marrjes së një vendimi të tillë. Për një gjë, ata do t' a marrin vesh se jeta e tyre nuk paska qenë kurr aq e mirë. Përderisa shumë gjëra u bënëin jetërat e skëtershme, ata do të fillojnë të jetojnë jetën në këtë botë duke ia përngjarë jetës në Parajsë. Çdo begati do të merr një kuptim të ri, dhe ata përfundimisht do të kuptojnë se sa gjëra të mrekullueshme përreth tyre u japin gëzim, kënaqësi dhe lumturi. Për herë të parë ata me të vërtetë do të gëzojnë dashuri dhe do të jenë të dashur nga dikush, ata do të përjetojnë gëzimin që sjellin miqësia, besimi dhe morali i mirë. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha është, se ata do të ndijnë një kënaqësi të thellë duke pasur Allahun si shok të tyrin dhe shpresën për t' a fituar dashurinë e Tij, miqësinë e ngushtë dhe pëlqimin.

**Premtimi i All-llahut është (ky), All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk po dinë.** (Rum 6)

Ai shpall lajmet e mira të bukurisë së pafund të jetës në Parajsë të atyre të cilët kanë gjetur strehim tek Ai dhe i kanë kyer provimet e tyre me durim. Në të dy botërat Allahu u ofron njerëzve jetën më të mirë, e cila u përshtatet shpirtit të tyre.

Për këtë arsye, gjithkush duhet t'a kuptoj këtë realitet dhe të angazhohet me ndërgjegje për t'a realizuar këtë.

Cila është e preferueshme? Disa dekada të jolumturisë, brengës dhe shqetësimit gjatë të cilave të gjitha kënaqësitë janë konsumuar dhe pasojnë me një jetë të agonisë në Ferr, ose një jetë e miqësisë, afërsisë dhe miqësisë së ngushtë me Allahun, në të cilën fitohet pëlqimi i Tij; një jetë e kënaqshme dhe e sigurtë në të cilën çdo moment është i mbushur me kënaqësi që përcillet në jetën e përhershme të Parajsës, kënaqësitë e së cilës nuk do të harxhohen kurrë?

Sigurisht, rruga e vetme për ata të cilët përdorin mendjet dhe ndërgjegjën e tyre është rruga e nënshtimit ndaj Allahut dhe përcjellja e parimeve morale të Kur'anit. Me shpresë, ky libër do t'u mundësoj njerëzve të shohin këtë realitet dhe t'fitojnë mëshirën e Tij.

O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (Përqafoni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik i juaji i hapët. (Bekare 208)

## MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

**D**arvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darvinizmit dhe



e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

### **Dështimi shkencor i Darwinizmit**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

### **Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### **“Jeta rrjedh nga jeta”**

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai

supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohej në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: *“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”*<sup>1</sup>

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

## Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

*Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>2</sup>*

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>3</sup>

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>4</sup>

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips

i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?*<sup>5</sup>

### **Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohet një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa

proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

*Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëerën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.<sup>6</sup>*

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

### **Mekanizmat imagjinarë të evolucionit**

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi

mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.<sup>7</sup>*

### **Ndikimi i Lamarkut**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të

arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>8</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

### **Neo-darvinizmi dhe mutacionet**

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p. sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.



Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.<sup>9</sup>*

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëjë asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

### **Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të*

*panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”<sup>10</sup>*

### **Shpresat e venitura të Darvinit**

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.<sup>11</sup>*

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

*Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e*

*gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.<sup>12</sup>*

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

### **Përralla e evolucionit të njeriut**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard,

dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.<sup>13</sup>

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”<sup>14</sup>

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>15</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.<sup>16</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej

paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrsokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.<sup>17</sup>*

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit

u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkencë biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në njëjtën kohë.<sup>18</sup>*

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

### **Formula e Darvinit!**

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomeve nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë

çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepja, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të



ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

### **Teknologjia e syrit dhe veshit**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpiknin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të

brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

## **Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

## **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja*

*jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.<sup>19</sup>*

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

### **Teoria e evolucionit:**

#### **Magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na

përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijëni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

**Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)**

**... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:



**“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinj të tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)**

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Breatat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.<sup>20</sup>*

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti

do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

.....

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je  
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër  
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,  
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”***  
***(Sure Bekare: 32)***

## SHËNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neë York, p. 127.
8. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983, p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Ëalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ëith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
19. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Ëorld," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43.